



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



Aspekte praktike të zbatimit të Rregullores No. 1896/2006 “Mbi krijimin e procedurës së urdhrit europian për pagesë”

TRAJNIM

PËRMBUSHJA DHE EKZEKUTIMI I DETYRIMEVE NDËRKUFITARE NË BE

PËRDORIMI EFIKAS I PROCEDURAVE NDËRKUFITARE EUROPIANE

Tiranë, 12 -13 Dhjetor 2020



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



Rasti Studimor 1: Wettsport-GmbH

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

Faktet:

Z. Corleone, një shtetas italian me vendbanim në Itali ka lidhur një kontratë me shoqërinë austriake *Wettsport-GmbH* (selia e shoqërisë në Innsbruck), e cila organizon shërbime të basteve sportive. Z. Corleone kishte detyrim në bazë të kontratës të krijonte dhe operonte shërbime të tilla bastesh në Itali. Në veçanti, atij iu kërkua të mbledhë baste nga zyrat lokale të basteve dhe të dërgojë shumat përkatëse në *Wettsport-GmbH*, pas zbritjes së fitimeve të paguara lojtarëve.



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



Rasti Studimor 1: Wettsport-GmbH

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

Pyetja 1: Wettsport-GmbH pretendon se Z. Corleone nuk ka përmbushur detyrimet kontraktore dhe për rrjedhojë i detyrohet asaj një shumë prej 16.406- EUR. Prandaj, Wettsport-GmbH dëshiron të paraqesë një aplikim për një urdhër evropian për pagesë. Cila gjykatë ka juridiksion ndërkombëtar?



Rasti Studimor 1: Wettsport-GmbH

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

Përgjigje 1:

Sipas **nenit 6 (1) të Rregullores Nr. 1896/2006** juridiksioni do të përcaktohet në përputhje me rregullat përkatëse të së drejtës komunitare, në veçanti me Rregulloren (KE) Nr. 44/2001 (tani Rregullorja 1215/2012). Prandaj, neni 7 (1) paragrafët a dhe b të Rregullores Nr. 1215/2012 janë të rëndësishëm: Një person me vendbanim në një Shtet Anëtar mund të paditet në Shtetet e tjera Anëtare, në çështje që lidhen me një kontratë, në gjykatat e vendit të përmbushjes së detyrimit në fjalë. Për qëllim të kësaj dispozite dhe nëse nuk është rënë dakord ndryshe, në rastin e ofrimit të shërbimeve **vendi i përmbushjes së detyrimit** në fjalë do të jetë vendi në një shtet anëtar ku, sipas kontratës, ishin ofruar ose duhet të ishin ofruar shërbimet. Në rastin në shqyrtim vendi i përmbushjes së detyrimit është në Itali. Prandaj, **gjykatat italiane** kanë juridiksion ndërkombëtar.



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



Rasti Studimor 1: Wettsport-GmbH

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

Skenari II:

Wettsport-GmbH paraqet aplikimin për urdhër evropian për pagesë pranë Bezirksgericht für Handelssachen Wien (Gjykata për Çështje Tregtare e Qarkut Vjenë).

Pyetja 2: Çfarë kushtesh në lidhje me aplikimin duhet të ketë parasysh Wettsport-GmbH?

Pyetja 3: Si mund të mbrohet Z. Corleone?



Rasti Studimor 1: Wettspport-GmbH

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

Përgjigje 2:

Wettspport-GmbH duhet të marrë parasysh kërkesat e përcaktuara në nenin 7 të Rregullores Nr. 1896/2006. Para së gjithash, një aplikim për një urdhër evropian pagese do të bëhet duke përdorur formularin standard A, i cili mund të gjendet në Aneksin I të Rregullores, si dhe në portalin e-drejtësia të Bashkimit Evropian. Neni 7 (2) i Rregullores Nr. 1896/2006 përcakton më tej përmbajtjen e detyrueshme të aplikimit. Për më tepër, sipas nenit 7 (4) të Rregullores Nr. 1896/2006 ekziston mundësia që paditësi të tregojë në Shtojcën e aplikimit se cila procedurë në kuptim të nenit 17 (1) para a ose b të Rregullores Nr. 1896/2006 duhet të zbatohet në rast kundërshtimi nga i padituri. Më tej citon se paditësi lejohet të kundërshtojë transferimin në proces të zakonshëm civil në kuptim të nenit 17 të Rregullores Nr. 1896/2006 në rast kundërshtimi nga i padituri. Kërkesa do të paraqitet në formë shkresore ose me ndonjë mjet tjetër komunikimi, përfshirë elektronik, të pranuar nga Shteti Anëtar i origjinës, dhe i disponueshëm për gjykatën e origjinës (neni 7 (5) i Rregullores Nr. 1896/2006).



Rasti Studimor 1: Wettsport-GmbH

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

Përgjigje 3:

Sipas nenit 16 (2) të Rregullores Nr. 1896/2006 i padituri mund të paraqesë një deklaratë kundërshtimi ndaj urdhrit evropian për pagesë në gjykatën e origjinës duke përdorur formularin standard F brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit të urdhrit të paditurit. Në deklaratën e kundërshtimit, i padituri do të tregojë se ai e kundërshton padinë, pa pasur nevojë të specifikojë arsyet për këtë. Deklarata e kundërshtimit duhet të dorëzohet në formë shkresore ose me ndonjë mjet tjetër komunikimi, përfshirë elektronik, të pranuar nga Shteti Anëtar i origjinës, dhe i disponueshëm për gjykatën e origjinës (neni 16 (4) i Rregullores Nr. 1896)/2006). I padituri nuk është i detyruar të paraqesë deklaratë kundërshtimi. Ai gjithashtu mund të paguajë shumën e treguar në urdhër paditësit (neni 12 (3) para a i Rregullores nr. 1896/2006).



Rasti Studimor 1: Wettsport-GmbH

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

Skenari III:

- Z. Corleone paraqiti një deklaratë kundërshtimi brenda afatit të caktuar. Arsyet e kundërshtimit të tij ishin se padia ishte e pabazuar dhe se shuma e kërkuar nuk ishte ende e pagueshme. Prandaj, Gjykata për Çështje Tregtare e Qarkut Vjenë e referoi çështjen në Landesgericht Innsbruck (Gjykata Rajonale e Innsbruck), duke mbajtur qëndrimin se kjo e fundit ishte gjykata kompetente për procesin e zakonshëm civil në kuptimi të nenit 17 (1) të Rregullores Nr 1896/2006. Në Gjykatën Rajonale, Z. Corleone për herë të parë ngriti pretendimin për mungesë juridiksioni të gjykatave austriake me arsyetimin se ai ishte me vendbanim në Itali. Nga ana tjetër, Wettsport-GmbH pretendoi se Gjykata ka juridiksion sipas nenit 7 (1) (a) të Rregullores Nr. 1215/2012. Në çdo rast, ata parashtruan se Gjykata Rajonale kishte juridiksion sipas nenit 26 të Rregullores Nr. 1215/2012, pasi Z. Corleone duke mos ngritur pretendimin për mungesën e juridiksionit kur paraqiti deklaratën e kundërshtimit ndaj urdhrit evropian për pagesë, ishte paraqitur në kuptim të atij neni.



Rasti Studimor 1: Wettsport-GmbH

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

- **Pyetja 4:** A përbën deklarata e kundërshtimit të një urdhri european për pagesë, në të cilin juridiksioni i gjykatës së Shtetit Anëtar të origjinës nuk kontestohet, paraqitje sipas nenit 26 të Rregullores Nr. 1215/2012 kur ajo deklaratë kundërshtimi nuk shoqërohet me argumente mbi themelin e çështjes?
- **Pyetja 5:** A do të kishte ndonjë ndryshim nëse deklarata e kundërshtimit do të shoqërohej me argumente mbi themelin e çështjes?
- **Pyetja 6:** Nëse supozojmë se Z. Corleone **nuk paraqiti** një deklaratë kundërshtimi brenda afatit të caktuar në gjykatën e origjinës, cilat do të ishin pasojat?



Rasti Studimor 1: Wettsport-GmbH

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

Përgjigje 4:

Sipas vendimit ECJ C-144/12 (Goldbet) nuk mund të shihet si paraqitjeje në kuptim të nenit 24 të Rregullores Nr. 44/2001 (tani neni 26 i Rregullores Nr. 1215/2012). Deklarata e kundërshtimit nuk mund të prodhojë efekte të tjera, në lidhje me të paditurin, përveç atyre që rrjedhin nga neni 17 (1) i Rregullores Nr. 1896/2006. Prandaj, pasoja e vetme mund të jetë që procedura e urdhrit evropian për pagesë të përfundojë dhe procedura të vazhdojë si një proces i zakonshëm civil (ose një Procedurë Evropiane e Padive me Vlerë të Vogël sipas nenit 17 (1) (a) të Rregullores Nr. 1896/2006) Gjithashtu, formulari standard, i cili do të përdoret për deklaratën e kundërshtimit, nuk ofron asnjë mundësi për të kundërshtuar juridiksionin e gjykatave të Shtetit Anëtar të Origjinës. Si pasojë, një deklaratë kundërshtimi ndaj urdhrit evropian për pagesë, e cila nuk përmban asnjë kundërshtim për juridiksionin e gjykatave të Shtetit Anëtar të origjinës dhe e cila nuk është e shoqëruar me argumente mbi themelin e çështjes, nuk mund të konsiderohet se përbën paraqitje në kuptim të nenit 26 të Rregullores Nr. 1215/2012. (C-144/12 Nr. 34)



Rasti Studimor 1: Wettsport-GmbH

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

Përgjigje 5:

Jo. Gjykata e Evropiane Drejtësisë u shpreh se interpretimi i deklaratës së kundërshtimit si mbrojtje e parë do të çonte në përfundimin se procedura e urdhrit evropian për pagesë dhe procesi i zakonshëm civil janë në thelb një procedurë. Sidoqoftë, një interpretim i tillë do të ishte i vështirë të pajtohet me faktin se procedura sipas Rregullores Nr. 1896/2006 ndjek rregullat e përcaktuara në atë rregullore, ndërsa procesi i zakonshëm ndjek rregullat e procedurës civile kombëtare (neni 17 (1) (b)) ose, nëse është e zbatueshme, ndjek rregullat e Rregullores Nr. 861/2007 për Paditë me Vlerë të Vogël. Gjithashtu, nuk është e nevojshme që Gjykata e Origjinës të ketë gjithashtu juridiksion për procesin e zakonshëm civil. Për më tepër, një interpretim, sipas të cilit deklarata e kundërshtimit, e shoqëruar me argumente mbi themelin e çështjes, duhet të konsiderohet si mbrojtja e parë, bie ndesh me objektivin e deklaratës së kundërshtimit të urdhrit evropian për pagesë (C-144 / 12 Nr 40). Në Rregullore nuk ka asnjë dispozitë që përcakton se i padituri do të specifikojë arsyet e kundërshtimit të tij; përkundrazi, neni 16 (3) thotë që i padituri nuk duhet të specifikojë arsyet e tij. Prandaj, qëllimi i deklaratës së kundërshtimit është që t'i jepet të paditurit një mundësi për të kundërshtuar padinë (pasi ai nuk është dëgjuar për lëshimin e urdhrit Evropian për pagesë) dhe të mos shërbejë si një mjet mbrojtje kundër themelit.



Rasti Studimor 1: Wettsport-GmbH

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

Përgjigje 6:

Gjykata e origjinës duhet të deklarojë urdhrin evropian për pagesë të ekzekutueshëm pa vonesë. Për këtë qëllim, një formular standard (G) sigurohet nga BE. Gjykata duhet të verifikojë datën e njoftimit (neni 18 (1) i Rregullores Nr. 1896/2006). Kërkesat formale për ekzekutimin rregullohen nga ligji i Shtetit Anëtar të origjinës (neni 18 (2) i Rregullores Nr. 1896/2006). Urdhri i ekzekutueshëm për pagesë do t'i dërgohet paditësit (neni 18 (3) i Rregullores Nr. 1896/2006). Një urdhër i tillë i ekzekutueshëm evropian për pagesë do të njihet dhe zbatohet në çdo shtet tjetër anëtar pa pasur nevojë për një deklaratë të ekzekutueshmërisë/urdhër ekzekutimi (neni 19 i Rregullores Nr. 1896/2006).



Rasti Studimor 2: Të jesh apo të mos jesh (njoftuar)

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

Faktet:

- Z. Huber, një shtetas gjerman me vendbanim në Mynih, lidhi një kontratë me Znj. Müller, një tjetër shtetase gjermane me vendbanim në Grac (Austri), e cila zotëron atje një zyrë ligjore. Sipas kontratës, Znj. Müller është e detyruar të paguajë € 150,000 për një kuzhinë me dizajn modern për zyrën e saj ligjore. Z. Huber e dorëzon kuzhinën në Grac, por Znj. Müller nuk paguan. Prandaj, Z. Huber dëshiron të paraqesë një aplikim për një urdhër evropian për pagesë kundër Znj. Müller.



Rasti Studimor 2: Të jesh apo të mos jesh (njoftuar)

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

- **Pyetja 1:** Cila gjykatë ka juridiksion ndërkombëtar për aplikimin e tij?
- **Pyetja 2:** Duke supozuar se Znj. Müller lidh kontratën me z. Huber për banesën e saj private (në këtë drejtim, ajo është konsumatore), cila gjykatë ka juridiksion ndërkombëtar?
- **Pyetja 3:** Duke supozuar se gjykatat austriake kanë juridiksion ndërkombëtar: Cila gjykatë kombëtare ka juridiksion për urdhrin evropian për pagesë?



Rasti Studimor 2: Të jesh apo të mos jesh (njoftuar)

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

Përgjigje 1:

- Sipas nenit 6 (1) të Rregullores Nr. 1896/2006 juridiksioni do të përcaktohet në përputhje me rregullat përkatëse të së drejtës Komunitare, në veçanti me Rregulloren (KE) Nr. 44/2001 (tani: Rregullorja 1215/2012). Prandaj, neni 7 (1) paragrafët a dhe b të Rregullores Nr. 1215/2012 janë të rëndësishme: Një person me vendbanim në një Shtet Anëtar mund të paditet në Shtetet e tjera Anëtare, në çështje që lidhen me një kontratë, në gjykatat e vendit të përmbushjes së detyrimit në fjalë. Meqenëse përmbushja e detyrimit ndodhi në Grac, Austri, gjykatat austriake kanë juridiksion ndërkombëtar.



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



Rasti Studimor 2: Të jesh apo të mos jesh (njoftuar)

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

Përgjigje 2:

Sipas **nenit 6 (2) të Rregullores Nr. 1896/2006** vetëm gjykatat e Shtetit Anëtar në të cilin ka vendbanimin i padituri (në kuptim të nenit 62 Reg Nr 1215/2012) do të kenë juridiksion. Meqenëse Znj. Müller është me vendbanim në Grac, Austri, gjykatat austriake (përsëri) kanë juridiksionin ndërkombëtar.



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



Rasti Studimor 2: Të jesh apo të mos jesh (njoftuar)

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

Përgjigje 3:

Paragrafi 252 (2) i Kodit të Procedurës Civile (Zivilprozessordnung) parashikon: Bezirksgericht für Handelssachen Wien (Gjykata për Çështjet Tregtare e Qarkut Vjenë) do të ketë **juridiksion ekskluziv** mbi zbatimin e procedurës së urdhrit evropian për pagesë.



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



Rasti Studimor 2: Të jesh apo të mos jesh (njoftuar)

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

Përgjigje 3:

Paragrafi 252 (2) i Kodit të Procedurës Civile (Zivilprozessordnung) parashikon: Bezirksgericht für Handelssachen Wien (Gjykata për Çështjet Tregtare e Qarkut Vjenë) do të ketë **juridiksion ekskluziv** mbi zbatimin e procedurës së urdhrit evropian për pagesë.



Rasti Studimor 2: Të jesh apo të mos jesh (njoftuar)

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

- **Skenari II:**

Më pas, gjykata austriake lëshon një urdhër evropian për pagesë në përputhje me nenin 12 të Rregullores nr. 1896/2006. Sidoqoftë, Znj. Müller ishte me pushime gjatë njoftimit të urdhrit, prandaj ai iu dorëzua sekretarit të saj, Z. Meyer. Fatkeqësisht, Z. Meyer harroi t'ia dorëzonte urdhrin Znj. Müller kur ajo u kthye, prandaj, ajo nuk ishte në gjendje të paraqiste një deklaratë kundërshtimi brenda afatit prej 30 ditësh.



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



Rasti Studimor 2: Të jesh apo të mos jesh (njoftuar)

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

- **Pyetja 4:** A ishte njoftimi i urdhrit evropian për pagesë sekretarit të Znj. Müller në përputhje me rregulloren Nr. 1896/2006?
- **Pyetja 5:** Në cilat rrethana Znj. Müller do të ishte në gjendje të aplikonte për një rishikim të çështjes së saj?



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



Rasti Studimor 2: Të jesh apo të mos jesh (njoftuar)

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

- **Përgjigje 4:**
- Po, në përputhje me nenin 14 (1) (b) të Rregullores Nr. 1896/2006 njoftimi i një urdhri evropian për pagesë mund t'i dorëzohet gjithashtu një personi, i cili është i punësuar nga i padituri.



Rasti Studimor 2: Të jesh apo të mos jesh (njoftuar)

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

- **Përgjigje 5:**
- Sipas nenit 20 të Rregullores Nr. 1896/2006, i padituri ka të drejtë të aplikojë për rishikim kur urdhri evropian për pagesë është njoftuar me një nga metodat e parashikuara në nenin 14 dhe njoftimi nuk është kryer në kohën e mjaftueshme për t'i mundësuar atij/asaj që të përgatitet për mbrojtjen, pa asnjë faj nga ana e palës (rasti 1) ose i padituri u pengua të kundërshtonte kërkesën për shkak të forcës madhore ose për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme pa ndonjë faj nga ana e tij (rasti 2). Në rastin e Znj. Müller, vetëm rasti 1 mund t'i japë asaj mundësi për një kërkesë për rishikim. Sipas doktrinës, keqorganizimi i zyrës mund të shihet si faj i të paditurit. (Kodek në Fasching / Konecny, Zivilprozessgesetze Art 20 EuMahnVO Rz 17).



Rasti Studimor 2: Të jesh apo të mos jesh (njoftuar)

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

- **Skenari III:**
- Gjykata rrëzon kërkesën e Znj. Müller për rishikim sipas nenit 20 (3) nënparagrafi 1 i Rregullores Nr. 1896/2006. Sidoqoftë, Znj. Müller refuzon të paguajë.
- **Pyetja 6:** Çfarë ndodh nëse Znj. Müller nuk e ekzekuton urdhrin evropian për pagesë? Si mund të ekzekutohet ai?



Rasti Studimor 2: Të jesh apo të mos jesh (njoftuar)

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Gracit

- **Përgjigje 6:**
- Meqenëse urdhri evropian për pagesë është një titull ekzekutiv, i cili nuk ka nevojë të deklarohet i ekzekutueshëm nga ndonjë Shtet Anëtar tjetër (neni 19 i Rregullores Nr. 1896/2006), Z. Huber, mund të kërkojë drejtpërdrejt ekzekutimin. Procedura e ekzekutimit rregullohet nga ligji i Shtetit Anëtar ku do të bëhet ekzekutimi (neni 21 (1) i Rregullores nr. 1896/2006). Prandaj, nëse Z. Huber dëshiron të ekzekutojë urdhrin e tij evropian për pagesë në Austri, ligji austriak mbi ekzekutimin është i zbatueshëm.



Rasti Studimor 3:UEP dhe Kushtet Kontraktuale të padrejta

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Rijekës: D. Vrbljanac dhe I. Kunda

- **Faktet:**

- Z. Balbi, shtetas italian, me vendbanim në Trieste vendosi të kalojë pushimet e tij në Kroaci në 2018. Ai rezervoi qëndrimin në ishullin e Cres në një resort në pronësi të shoqërisë Gold Sun d.o.o., e cila reklamonte veten përmes reklamave në faqet e internetit dhe gazeta në shtete të ndryshme anëtare duke përfshirë Italinë. I pakënaqur me shërbimin, ai u largua nga resorti pa paguar. Gold Sun d.o.o. paraqiti një kërkesë në Gjykatën e Rrethit në Rijeka për një Urdhër Evropian për Pagesë kundër Z. Balbi. Si pjesë e Seksionit 10 të Formularit A, Gold Sun d.o.o. paraqiti kontratën e lidhur me Z. Balbi, e cila përmbante një klauzolë prorogimi që i jep juridiksion Gjykatës së Rrethit në Rijeka për të gjitha pretendimet që lindin nga kontrata. Gjykata e Rrethit kërkoi nga Gold Sun d.o.o. të paraqesë dokumentacion shtesë në lidhje me kontratën, veçanërisht Termat dhe Kushtet e saj, të cilave iu referohej kontrata me qëllim të ushtrimit të kontrollit mbi kushtet kontraktuale në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit me të cilin Direktiva 93/13 mbi kushtet e padrejta në kontratat e konsumatorit u transpozua në ligjin kroat.



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



Rasti Studimor 3:UEP dhe Kushtet Kontraktuale të padrejta

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Rijekës: D. Vrbljanac dhe I. Kunda

- **Pyetja 1:** A ka juridiksion Gjykata e Rrethit në Rijeka për të vendosur mbi çështjen?
- **Pyetja 2:** Si mund të zgjidhet çështja e paraqitjes së dokumenteve për qëllim të kontrollit *ex officio* të kushteve kontraktuale?



Rasti Studimor 3:UEP dhe Kushtet Kontraktuale të padrejta

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Rijekës: D. Vrbljanac dhe I. Kunda

- Përgjigje 1:
- Çështja e juridiksionit për procedurat e Urdhrit Evropian për Pagesë (UEP) nuk është brenda fushës së Rregullores (KE) Nr.1896/2006. Përkundrazi, UEP i referohet regjimit të Rregullores së Brukselit I për përcaktimin e juridiksionit.
- Rregullorja e Brukselit I u zëvendësua nga Rregullorja (BE) Nr. 1215/2012. Zbatimi në kohë i Rregullores së Brukselit I bis varet nga dita kur ka filluar procesi. Në mënyrë që Rregullorja e Brukselit I bis të jetë e zbatueshme, procesi duhet të fillojë në ose pas 10 Janarit 2015. Duke pasur parasysh se Gold Sun d.o.o. filloi procesin në 2018, referimi në Rregulloren e Brukselit I në nenin 6 të Rregullores UEP duhet të kuptohet si referim në Rregulloren e Brukselit I bis.



Rasti Studimor 3:UEP dhe Kushtet Kontraktuale të padrejta

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Rijekës: D. Vrbljanac dhe I. Kunda

- Paragrafi 2 i nenit 6 të Rregullores UEP përmban rregullin e vetëm juridiksional në atë Rregullore që ka të bëjë me kontratat e konsumatorit. Ai përfaqëson një derogim nga rregullat e parashikruara në Rregulloren e Brukselit I bis, të cilat zbatohen kur kontrata në fjalë lidhet me konsumatorin. Neni 18 i Rregullores së Brukselit I bis përmban rregulla juridiksionale për kontratat e konsumatorit. Nëse konsumatori padit tregtarin, ai/ajo mund të zgjedhë midis dy forumeve: vendbanimin e tregtarit ose të tij/saj. Nëse pozicionet procedurale këmbehen, tregtari mund të fillojë procesin para gjykatës së Shtetit Anëtar në të cilin konsumatori ka vendbanimin.



Rasti Studimor 3:UEP dhe Kushtet Kontraktuale të padrejta

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Rijekës: D. Vrbljanac dhe I. Kunda

- Neni 18 nuk është baza e vetme juridiksionale sipas Rregullores së Brukselit I bis që mund të zbatohet për kontratat e mbrojtura të konsumatorit. Përveç nenit 18, dispozitat mbi prorogimin e juridiksionit (neni 19 dhe 25) dhe juridiksionit nëpërmjet paraqitjes (neni 26) mund të përdoren gjithashtu për krijimin e juridiksionit. Meqënëse neni 6 (2) i Rregullores UEP parashikon se “vetëm gjykatat në Shtetin Anëtar në të cilin i padituri është me vendbanim” janë kompetente, rrjedhimisht që dispozita përkatëse përjashton mundësinë e zbatimit të neneve 19 dhe 25 ose të nenit 26 të Rregullores së Brukselit I bis.
- Në çështjen hipotetike të paraqitur, juridiksion do të kishte gjykata italiane bazuar në nenin 6 (2) të Rregullores UEP, pasi Z. Balbi është me vendbanim në Itali. Kontrata midis Z. Balbi dhe Gold Sun d.o.o. përmban një klauzolë prorogimi që i jep juridiksion gjykatës kroate. Sidoqoftë, Rregullorja UEP përjashton mundësinë e ndonjë gjykate tjetër për të qenë kompetente në mosmarrëveshjet e konsumatorit kur konsumatori është i paditur, përfshirë gjykatën e zgjedhur nga palët. Prandaj, gjykata kroate do të duhej të pushonte gjykimin për moskompetencë bazuar në arsyet e mësipërme.



Rasti Studimor 3:UEP dhe Kushtet Kontraktuale të padrejta

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Rijekës: D. Vrbljanac dhe I. Kunda

- **Përgjigje 2:**
- Aplikimi për një UEP bëhet duke dorëzuar të plotësuar formularin A në Shtojcën e Rregullores UEP. Neni 7 (2) i Rregullores UEP përshkruan listën e informacionit që duhet të sigurohet kur dorëzohet një aplikim i tillë.
- Në një nga çështjet e saj më të fundit mbi Rregulloren UEP, *Bondora*, GJDBE shpjegoi nëse pikat (d) dhe (e) të lexuara së bashku me Direktivën 93/13 mbi kushtet e padrejta në kontratat e konsumatorit (OJ L 95, 21.4.1993, f. 29–34) lejojnë që gjykata kombëtare të kërkojë nga kreditori informacion shtesë në lidhje me kushtet e marrëveshjes në të cilën mbështetet kërkesa në fjalë, në mënyrë që të verifikojë *ex officio* (pa) drejtësinë e kushteve.
- Në çështjen hipotetike, çdo gjykatë kombëtare që është vënë në lëvizje me një kërkesë sipas Rregullores UEP, lejohet të kërkojë nga kompania Gold Sun d.o.o. të paraqesë Termat dhe Kushtet në mënyrë që të mund të ushtrojë kontrollin *ex officio* mbi kushtet kontraktuale në kontratën e konsumatorit. Asnjë rregull kombëtar nuk mund ta ndalojë gjykatën për ta bërë këtë.



Rasti Studimor 4: Urdhri Evropian për Pagesë dhe Rishikimi për mungesë juridiksioni

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Rijekës: Danijela Vrbljanac and Ivana Kunda

Faktet:

- Znj. Pelič, një shtetase sllovene, me vendbanim në Slloveni, ka lidhur një kontratë me shoqërinë gjermane Sterne Hause GmbH në lidhje me rinovimin e kompleksit të saj të apartamenteve për pushime në Slloveni, të cilën ajo ua jep me qira turistëve. Në Shkurt 2019, Sterne Hause GmbH aplikoi në gjykatën Gjermane për të lëshuar një urdhër evropian për pagesë kundër Znj. Pelič duke deklaruar se ajo i ka ofruar asaj shërbimin e rinovimit në kompleksin e saj të pushimeve të vendosur në Slloveni. Gjykata lëshoi urdhrin evropian për pagesë dhe ia njoftoi Znj. Pelič më 12 shtator 2019. Më 7 nëntor 2019, gjykata gjermane e shpalli urdhrin të ekzekutueshëm. Dy muaj më vonë, znj. Pelič bëri kërkesë për rishikim të urdhrin të lëshuar kundër saj me arsyetimin se gjykata që kishte lëshuar urdhrin nuk kishte kompetencë.



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



Rasti Studimor 4: Urdhri Evropian për Pagesë dhe Rishikimi për mungesë juridiksioni

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Rijekës: Danijela Vrbljanac and Ivana Kunda

- **Pyetja 1:** A kanë juridiksion gjykatat gjermane për të vendosur për rastin?
- **Pyetja 2:** A mundet pala të kundërshtojë juridiksionin në proceset UEP, kur dhe në çfarë rrethanash?



Rasti Studimor 4: Urdhri Evropian për Pagesë dhe Rishikimi për mungesë juridiksioni

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Rijekës: Danijela Vrbljanac and Ivana Kunda

- **Përgjigje 1:** Rregullorja (KE) Nr. 1896/2006 përmban vetëm një rregull juridiksioni, i cili është i zbatueshëm për kontratat e konsumatorit. Për të gjitha rastet e tjera, çështja e juridiksionit ndërkombëtar për procedurat e Urdhrit Evropian për Pagesë (UEP) rregullohet nga Rregullorja (BE) Nr. 1215/2012 e cila hyri në fuqi në 10 Janar 2015 duke zëvendësuar Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 44/2001.
- Zbatimi i nenit 6 (2) i Rregullores UEP varet nga fakti nëse çështja bazohet në kontratën e konsumatorit. Kontrata në rastin hipotetik në fjalë nuk mund të karakterizohet si një kontratë konsumatori pasi Znj. Pelič nuk e lidhi atë për qëllimet e saj private, por për aktivitetin profesional, i cili gjeneron të ardhura (për një përkufizim të kontratës së konsumatorit shih nenin 17 (1) të Rregullores së Brukselit I bis; C-27/02, *Engler*, BE: C: 2005: 33; C-96/00, *Gabriel*, BE: C: 2002: 436). Juridiksioni mbi kontratat e rinovimit të ambjenteve me përjashtim të kontratave të konsumatorëve rregullohet, ndër të tjera, nga neni 7 (1) dhe neni 4 (1) të Rregullores së Brukselit I bis.
- Zbatimi i nenit 7 (1), nënparagrafët (a) ose (b) dhe më poshtë, varet nga lloji i kontratës në fjalë. Kontrata midis Znj. Pelič dhe shoqërisë Sterne Hause GmbH bie nën nocionin e kontratës së “ofrimit të shërbimeve” (shih C-533/07, *Falco Privatstiftung dhe Rabitsch*, BE: C: 2009: 257). Prandaj, gjykatat kompetente sipas nenit 7 (1) duhet të jenë gjykatat sllovene, pasi shoqëria ofroi shërbimet e saj në Slloveni, ku ata rinovuan kompleksin e apartamenteve të zonjës Pelič. Rregulli i juridiksionit të posaçëm në nenin 7 (1) të Rregullores së Brukselit I bis plotësohet me rregullin e juridiksionit të përgjithshëm në nenin 4 të Rregullores së Brukselit I bis, i cili i jep juridiksion gjykatës së Shtetit Anëtar në të cilin i padituri ka vendbanimin. Zbatimi i rregullit të juridiksionit të përgjithshëm do të çonte gjithashtu në juridiksionin e gjykatave sllovene, sepse znj. Pelič është e paditur dhe vendbanimi i saj është në Slloveni



Rasti Studimor 4: Urdhri Evropian për Pagesë dhe Rishikimi për mungesë juridiksioni

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Rijekës: Danijela Vrbljanac and Ivana Kunda

- **Përgjigje 2:** Rregullorja UEP nuk përmban dispozita të posaçme në bazë të të cilave i padituri mund të kundërshtojë mungesën e juridiksionit të gjykatës së investuar. Megjithatë, në bazë të nenit 16 të saj, i padituri mund të kundërshtojë urdhrin evropian për pagesë pa specifikuar arsyet e kundërshtimit.
- Mundësia e dhënë në nenin 16 (1) të Rregullores UEP përfshin ndër të tjera të drejtën për të ngritur kundërshtimin për mungesën e juridiksionit. Përndryshe, rregullat e juridiksionit në nenin 6 të Rregullores UEP nuk do të kishin kuptim.
- Nga neni 16 (2), e drejta për të kundërshtuar urdhrin evropian për pagesë është e kufizuar në 30 ditë pas njoftimit të tij. Në rastin hipotetik të mësipërm, znj. Pelič nuk e kundërshtoi urdhrin brenda afatit kohor të specifikuar. Më pas mund të shtrohen pyetjet nëse ajo mund ta bëjë atë në një fazë të mëvonshme. Në përgjithësi, nëse i padituri nuk kundërshton urdhrin sipas nenit 16 të Rregullores UEP, ajo/ai ka një mundësi shtesë për të aplikuar për një rishikim të urdhrin në raste të jashtëzakonshme të parashikruara në nenin 20 të Rregullores UEP.



Rasti Studimor 4: Urdhri Evropian për Pagesë dhe Rishikimi për mungesë juridiksioni

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Rijekës: Danijela Vrbljanac and Ivana Kunda

- Në *Thomas Cook Belgjikë* (C-245/14, EU: C: 2015: 715), GJDBE diskutoi mundësinë e rishikimit të urdhrit evropian për pagesë në bazë të nenit 20 me arsyetimin se gjykata që lëshoi urdhrin nuk kishte juridiksion.
- GJDBE vendosi që në rrethanat përkatëse mund të ketë dy nivele të veçanta vlerësimi nëse Thomas Cook ka të drejtë për një rishikim sipas nenit 20 të Rregullores UEP: E para është nëse urdhri evropian për pagesë “qartazi është lëshuar gabimisht duke marrë parasysh kërkesat e përcaktuara në Rregulloren UEP”. Në vendimin e saj, GJDBE arsyetoi se ky nuk ishte rasti pasi gjykata kombëtare e investuar duhet të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë çështjen e juridiksionit dhe përshkrimin e provave, në bazë të informacionit të dhënë në formularin e aplikimit. Prandaj, kur i pandituri dëshiron të kundërshtojë juridiksionin e gjykatës duke deklaruar se informacioni i dhënë nga paditësi në formularin e aplikimit ishte i rremë, ai duhet ta bëjë këtë brenda afatit kohor për kundërshtimin e kërkesës në nenin 16 të Rregullores UEP. Niveli i dytë i vlerësimit, është nëse urdhri evropian i pagesës “qartazi ishte lëshuar gabimisht për shkak të rrethanave të tjera të jashtëzakonshme”. GJDBE deklaroi që, megjithëse në parim “rrethana të tjera të jashtëzakonshme” mund të përfshijnë një situatë kur urdhri evropian për pagesë ishte bazuar në informacione të rreme të siguruar nga paditësi në formularin e aplikimit, ky nuk ishte rasti në *Thomas Cook Belgjikë*. Konkretisht, pasi Thomas Cook ishte njoftuar për urdhrin procedural të pagesës në përputhje me dispozitat e Rregullores UEP, ai duhet të ketë qenë në dijeni të klauzolës së juridiksionit dhe arsyeve mbi të cilat gjykata e origjinës vendosi se kishte juridiksionin. Prandaj, ishte në gjendje të kundërshtonte urdhrin evropian për pagesë në bazë të nenit 16 të Rregullores UEP në fazën e kundërshtimit të procedurave. GJDBE më pas aplikoi nenin 25 të Rregullores UEP, i cili ndalon që neni 20 i Rregullores UEP të bëhet mundësia e dytë për të kundërshtuar padinë. Për këtë arsye, vendosi që në rrethanat konkrete në *Thomas Cook Belgjikë*, urdhri evropian për pagesë nuk mund të rishikohet në bazë të nenit 20 të Rregullores UEP për faktin se gjykata e origjinës nuk kishte juridiksion.



Rasti Studimor 4: Urdhri Evropian për Pagesë dhe Rishikimi për mungesë juridiksioni

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Rijekës: Danijela Vrbljanac and Ivana Kunda

- Vendim i 22 tetorit 2015, *Thomas Cook Belgjikë, C-245/14 “Neni 20 (2) i Rregullores UEP, duhet të interpretohet se, në rrethana të tilla si ato në fjalë në procedurën kryesore, përjashton një të paditur, të cilit i është njoftuar një urdhër evropian për pagesë në përputhje me atë Rregullore, nga e drejta për të aplikuar për rishikim të atij urdhri duke pretenduar se gjykata e origjinës gabimisht konstatoi se kishte juridiksion në bazë të pretendimit për informacion të rremë të siguruar nga paditësi në formularin e aplikimit.”*
- Në rrethanat kur pretendohet mungesa e juridiksionit të gjykatës së investuar për lëshimin e urdhrit evropian për pagesë, znj. Pelič mund të argumentojë se urdhri evropian për pagesë “qartazi ishte lëshuar gabimisht duke marrë parasysh kërkesat” në Rregulloren UEP, në veçanti kërkesa në nenin 8. Sipas kësaj dispozite, gjykata gjermane, ndër të tjera, duhej të shqyrtonte në bazë të formularit të aplikimit, nëse juridiksioni i saj mund të përcaktohet në përputhje me rregullat përkatëse të të drejtës së BE-së, veçanërisht me Rregulloren e Brukselit I bis. Duke u kthyer te faktet e çështjes, mund të shihet që formulari i aplikimit i Sterne Hause përmendi në mënyrë specifike shërbimet e ofruara në vendin slloven si bazë për pretendimin. Por ky fakt është në të njëjtën kohë edhe baza për juridiksionin e posaçëm sipas nenit 7 (1) (b) të Rregullores së Brukselit I, të cilin gjykata gjermane duhej ta vlerësonte duke pasur parasysh se ishte e qartë për të se nuk ishte kompetente për shkak të juridiksionit të përgjithshëm sipas nenit 4 (1) të Rregullores së Brukselit I, sepse adresa e të paditurit për njoftim u deklarua të ishte në Slloveni (në përputhje me nenin 6 (2) (a) të Rregullores UEP).



Rasti Studimor 4: Urdhri Evropian për Pagesë dhe Rishikimi për mungesë juridiksioni

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Rijekës: Danijela Vrbljanac and Ivana Kunda

- Në rastin hipotetik faktet mbi të cilat juridiksioni i posaçëm varet nga neni 7 (1) (b) i Rregullores së Brukselit I në fakt ishte theksuar qartë në formularin e aplikimit – në të përmendeshin në mënyrë specifike shërbimet e kryera në vendin slloven. Në një situatë të tillë, zonja Pelič do të ishte në gjendje të mbështetej në nenin 20 të Rregullores UEP në mënyrë që të lejohet rishikimi i urdhrit evropian të pagesës të lëshuar kundër saj me arsyetimin se gjykatës që e lëshoi i mungonte juridiksioni.



Rasti Studimor 5: Neni 16 – Kundërshtimi i UEP

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit Leibniz i Hannoverit dhe Universitetit të Tiranës

Faktet:

- Z, i cili ka vendbanimin/selinë në Francë aplikoi para gjykatës kompetente gjermane për lëshimin e një urdhri evropian për pagesë në shumën EUR 10.000 kundër Y, me vendbanim në Hannover, Gjermani. Gjykata në Gjermani e dha urdhrin evropian për pagesë kundër Y, duke lëshuar formularin E.
- Gjykata i njoftoi Y-së formularatët A dhe E si urdhër për pagesë së bashku me formularin F, formulari i kundërshtimit të urdhrit evropian për pagesë.



Rasti Studimor 5: Neni 16 – Kundërshtimi i UEP

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit Leibniz i Hannoverit dhe Universitetit të Tiranës

- **Skenari I:**
- Y refuzoi urdhrin evropian për pagesë duke mos përdorur formularin F, por ...
- (i) një letër informale drejtuar gjykatës.
- **Pyetja 1:** A është ky një kundërshtim efektiv i urdhrit evropian për pagesë?
- (ii) sisteme të komunikimit elektronik?
- **Pyetja 2:** A është ky një kundërshtim efektiv i urdhrit evropian për pagesë?



Rasti Studimor 5: Neni 16 – Kundërshtimi i UEP

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit Leibniz i Hannoverit dhe Universitetit të Tiranës

- **Përgjigje 1:** Po: në përputhje me Recitalin nr. 23 të Rregullores UEP, i padituri mund të përdorë një formë tjetër të shkruar për të parashtruar kundërshtimin nëse është mjaftueshëm specifik.
- **Përgjigje 2:** Po: me kusht që kërkesat e nenit 16(4) dhe (5) të Rregullores UEP të plotësohen.



Rasti Studimor 5: Neni 16 – Kundërshtimi i UEP

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit Leibniz i Hannoverit dhe Universitetit të Tiranës

- **Skenari II:**
- Y e dërgoi kundërshtimin brenda 30 ditëve nga njoftimi i urdhrit të gjykatës...
- (i) dhe ia drejtoi atë vetëm Z-së.
- **Pyetja 3:** A është ky një kundërshtim efektiv i urdhrit evropian për pagesë?
- (ii) elektronikisht. Kundërshtimi është marrë brenda afatit 30 ditor, por është printuar pas mbarimit të afatit.
- **Pyetja 4:** A është ky një kundërshtim efektiv i urdhrit evropian për pagesë?



Rasti Studimor 5: Neni 16 – Kundërshtimi i UEP

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit Leibniz i Hannoverit dhe Universitetit të Tiranës

- **Përgjigje 3:** Jo: Ligji gjerman kërkon që kundërshtimi t'i dërgohet gjykatës që i ka njoftuar urdhrin paditësit. Gjykata kompetente është gjykata vendore ("Amtsgericht") Berlin Wedding, § 1087 ZPO. Në shtete të tjera kjo mund të jetë ndryshe, shiko nenin 16(2) të Rregullores UEP.
- **Përgjigje 4:** Po: sipas ligjit gjerman, momenti i marrjes është përcaktues për zënien e afatit, § 1088 ZPO dhe § 130a V s. 1 ZPO.



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



Rasti Studimor 5: Neni 16 – Kundërshtimi i UEP

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit Leibniz i Hannoverit dhe Universitetit të Tiranës

- **Skenari III:**
- Y e dërgoi kundërshtimin pa përcaktuar arsyet për të.
- **Pyetja 5:** A është ky një kundërshtim efektiv i urdhrit evropian për pagesë?



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



Rasti Studimor 5: Neni 16 – Kundërshtimi i UEP

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit Leibniz i Hannoverit dhe Universitetit të Tiranës

- **Përgjigje 5:**
- Po: shiko nenin 16(3) të Rregullores UEP. Kundërshtimi është efektiv pa parashtruar asnjë arsye, nëse deklaron që i padituri e kundërshton padinë.



Rasti Studimor 5: Neni 16 – Kundërshtimi i UEP

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit Leibniz i Hannoverit dhe Universitetit të Tiranës

- **Skenari IV:**
- Y e dërgon kundërshtimin. Lidhur me nënshkrimin...
 - (i) Y harroi të nënshkruajë kundërshtimin.
- **Pyetja 6:** A është ky një kundërshtim efektiv i urdhrit evropian për pagesë?
 - (ii) përfaqësuesi ligjor i Y nënshkroi kundërshtimin, jo Y-ja vetë.
- **Pyetja 7:** A është ky një kundërshtim efektiv i urdhrit evropian për pagesë?
 - (iii) Y nënshkroi kundërshtimin duke përdorur një nënshkrim të skanuar.
- **Pyetja 8:** A është ky një kundërshtim efektiv i urdhrit evropian për pagesë?
 - (iv) Y e nënshkroi kundërshtimin personalisht.
- **Pyetja 9:** A është ky një kundërshtim efektiv i urdhrit evropian për pagesë?
 - (v) Y nënshkroi kundërshtimin, i cili paraqitet në formë elektronike, me një nënshkrim elektronik.
- **Pyetja 10:** A është ky një kundërshtim efektiv i urdhrit evropian për pagesë?



Rasti Studimor 5: Neni 16 – Kundërshtimi i UEP

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit Leibniz i Hannoverit dhe Universitetit të Tiranës

- **Përgjigje 6:** Jo: sipas nenit 16(5) të Rregullores UEP, i padituri duhet të nënshkruajë kundërshtimin.
- **Përgjigje 7:** Po: i padituri shprehimisht nuk është i detyruar të ketë përfaqësues ligjor, neni 24 (b) i Rregullores UEP. Kjo nënkupton se një përfaqësues ligjor, në përputhje me ligjin kombëtar (§ 79 II ZPO) mund të nënshkruajë kundërshtimin dhe ta bëjë atë efektiv për klientin, neni 16(5) të Rregullores UEP.
- **Përgjigje 8:** Jo: sipas nenit 16(5) të Rregullores UEP dhe rregullave kombëtare, nënshkrimi ose duhet të jetë me shkrim dore kur përdoret formulari i printuar ose duhet të jetë në përputhje me nenin 2 (2) të Direktivës 1999/93/EC kur përdoret formulari elektronik.
- **Përgjigje 9:** Po: kur përdoret dorëzimi jo-elektronik pa përfaqësim ligjor, i padituri duhet të nënshkruajë kundërshtimin personalisht, neni 16 (5) i Rregullores UEP.
- **Përgjigje 10:** Po: sipas Nenit 16 (5) UEP, kur përdoret dorëzimi elektronik, i padituri duhet të nënshkruajë kundërshtimin në formë elektronike në përputhje me Nenin 2 (2) të Direktivës 1999/93 / EC.



Rasti Studimor 5: Neni 16 – Kundërshtimi i UEP

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit Leibniz i Hannoverit dhe Universitetit të Tiranës

- **Skenari V:**
- Y humbet afatin e fundit për të paraqitur kundërshtimin e tij, sepse ...
- (i) Y ishte në spital për shkak të një aksidenti automobilistik.
- **Pyetja 11:** A është ky një kundërshtim efektiv edhe pse dërgohet përtej afatit të caktuar?
- (ii) Y harroi ta postojë në kohë. Më vonë, Y zbuloi se një nga dokumentet e përdorura nga paditësi Z për të provuar pretendimin e tij ishte i rremë.
- **Pyetja 12:** A është ky një kundërshtim efektiv edhe pse dërgohet përtej afatit të caktuar?
- (iii) brenda formularit E të UEP, nuk kishte asnjë informacion në lidhje me pasojat e moskundërshtimit të padisë pasi shprehja 'urdhri do të bëhet i ekzekutueshëm nëse deklarata e kundërshtimit nuk është depozituar në gjykatë në përputhje me nenin 16' nuk ishte e dukshme.
- **Pyetja 13:** A është ky një kundërshtim efektiv edhe pse dërgohet përtej afatit të caktuar?
- (iv) dita e fundit e afatit është një festë zyrtare në shtetin e vendbanimit të Y. Prandaj, Y paraqet deklaratën e tij të kundërshtimit ditën tjetër të punës.
- **Pyetja 14:** A është ky një kundërshtim efektiv edhe pse dërgohet përtej afatit të caktuar?



Rasti Studimor 5: Neni 16 – Kundërshtimi i UEP

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit Leibniz i Hannoverit dhe Universitetit të Tiranës

- **Përgjigje 11:** Po: sipas Nenit 20 (1) (b) të Rregullores UEP, Y u pengua të kundërshtonte padinë për shkak të forcës madhore pa ndonjë faj nga ana e tij, shih gjithashtu § 1092 ZPO.
- **Përgjigje 12:** Po: sipas Recitalit nr. 25 të Rregullores UEP, i padituri mund të ketë të drejtë të aplikojë për një rishikim të UEP në raste të jashtëzakonshme. Sidoqoftë, kjo nuk duhet t'i japë të paditurit një mundësi të dytë për të kundërshtuar padinë. Një rrethanë e jashtëzakonshme mund të përfshijë një situatë kur UEP ishte bazuar në informacione të rreme të dhëna në formularin e aplikimit.
- **Përgjigje 13:** Po: sipas Recitalit nr. 18 dhe nenit 16 (1) të Rregullores UEP të paditurit duhet t'i sigurohet informacioni i plotë në lidhje me padinë, siç është dhënë nga paditësi dhe duhet të këshillohet për rëndësinë ligjore të UEP-së dhe pasojat e moskundërshtimit të padisë.
- **Përgjigje 14 :** Po: sipas Recitalit nr. 28 dhe nenit 3 (4) të Rregullores (KEE, Euratom) Nr. 1182/71 të Këshillit të 3 Qershorit 1971, nëse e njëjta datë është një festë zyrtare në Shtetin Anëtar të origjinës, deklarata e kundërshtimit është efektive.



Rasti Studimor 5: Neni 16 – Kundërshtimi i UEP

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit Leibniz i Hannoverit dhe Universitetit të Tiranës

- **Skenari VI:**
- Pas afatit të njoftimit të UEP, Y ka transferuar vendbanimin e saj në Shqipëri.
- **Pyetja 15:** A mund ta ushtrojë Y të drejtën e kundërshtimit sipas nenit 16 të Rregullores UEP?



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



Rasti Studimor 5: Neni 16 – Kundërshtimi i UEP

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit Leibniz i Hannoverit dhe Universitetit të Tiranës

Përgjigje 15:

- Po: sipas Nenit 3 (3) të Rregullores UEP, momenti përkatës për të përcaktuar nëse ekziston një çështje ndërkufitare do të jetë koha kur aplikimi për një UEP paraqitet në përputhje me Rregulloren UEP.



Rasti Studimor 6: Neni 17: Efektet e paraqitjes së një deklaratë kundërshtimi

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit Leibniz i Hanoverit dhe Universitetit të Tiranës

- **Faktet:**

Fakte të njëjta si në Rastin Studimor 5: Neni 16 - Kundërshtimi i Urdhrit Evropian për Pagesë. Gjithashtu, Y paraqiti një kundërshtim efektiv kundër urdhrin evropian për pagesë.

- **Skenari I:**

Z, paditësi, shprehimisht kërkoi që ...

(i) nuk dëshiron të vazhdojë gjykimin, por të ndërpresë procesin kur i padituri kundërshton urdhrin.

Pyetja 1: A do të vazhdojë procesi?

(ii) dëshiron të vazhdojë gjykimin menjëherë pas lëshimit të UEP.

Pyetja 2: A do të vazhdojë procesi?

(iii) dëshiron të vazhdojë gjykimin dhe e bën këtë kërkesë me anë të një letre të thjeshtë me shkrim.

Pyetja 3: A do të merret parasysh kjo letër kur shqyrtohet kërkesa?



Rasti Studimor 6: Neni 17: Efektet e paraqitjes së një deklaratë kundërshtimi

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit Leibniz i Hanoverit dhe Universitetit të Tiranës

- **Përgjigje 1:** Jo: sipas nenit 17 (1), procesi duhet të përfundojë në atë rast.
- **Përgjigje 2:** Po: sipas Nenit 7 (4) të Rregullores UEP, paditësi mund të bëjë një kërkesë të tillë në çdo kohë derisa të lëshohet UEP.
- **Përgjigje 3:** Po: UEP nuk parashikon ndonjë formë tjetër.



Rasti Studimor 6: Neni 17: Efektet e paraqitjes së një deklaratë kundërshtimi

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit Leibniz i Hanoverit dhe Universitetit të Tiranës

- **Skenari II:**
- Z ka caktuar gjykatën, e cila, sipas tij, është kompetente për procesin me palë kundërshtare.
- (i) Z ka caktuar gjykatën e rrethit ("Landgericht") Berlin si atë kompetente për procesin me palë kundërshtare.
- **Pyetja 4:** A fillon procesi me palë kundërshtare në gjykatën e rrethit në Berlin?
- (ii) Z ka caktuar gjykatën lokale ("Amtsgericht") Hannover si atë kompetente për procesin me palë kundërshtare.
- **Pyetja 5:** A fillon procesi me palë kundërshtare në gjykatën lokale Hannover?
- (iii) Z ka caktuar gjykatën kompetente për UEP në Gjermani (gjykata lokale ("Amtsgericht") Berlin Wedding) si kompetente për procesin me palë kundërshtare.
- **Pyetja 6:** A fillon procesi me palë kundërshtare në gjykatën lokale Berlin Wedding?



Rasti Studimor 6: Neni 17: Efektet e paraqitjes së një deklaratë kundërshtimi

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit Leibniz i Hanoverit dhe Universitetit të Tiranës

- **Përgjigje 4:** Po: sipas Nenit 17 (2) të Rregullores UEP, ligji gjerman rregullon transferimin në procesin e zakonshëm civil. Kompetenca *tokësore* mund të krijohet nëse Y diskuton mbi themelin e çështjes pa kundërshtim dhe nuk ka kompetencë ekskluzive, §§ 39, 40 II Nr. 2 ZPO. Për më tepër, sipas § 78 I ZPO, përfaqësimi ligjor kërkohet përpara gjykatës së rrethit, prandaj Y dhe Z duhet të përfaqësohen nga një avokat.
- **Përgjigje 5:** Jo: sipas nenit 17 (2) të Rregullores UEP, ligji gjerman rregullon transferimin në procesin e zakonshëm civil. Gjykata kompetente është gjykata e rrethit (“Landgericht”) Hannover, §13 ZPO, § 71 GVG. Kompetenca lëndore nuk mund të krijohet duke diskutuar mbi themelin e çështjes. Gjykata lokale Hannover do t’ia referonte çështjen *ex officio* gjykatës së rrethit (“Landgericht”) Hannover. Gjithashtu, Y dhe Z kërkohet të përfaqësohen nga një avokat përpara një gjykate rrethi, § 78 I ZPO.
- **Përgjigje 6:** Jo: sipas nenit 17 (2) të Rregullores UEP, ligji gjerman rregullon transferimin në procesin e zakonshëm civil. Meqënëse Z identifikoi gabimisht jo vetëm kompetencën tokësore (Berlin në vend të Hannoverit) por edhe lëndore (gjykatë lokale në vend të gjykatës së rrethit), gjykata lokale Berlin Wedding do ta referonte çështjen *ex officio* në gjykatën e rrethit Hannover. Gjithashtu, Y dhe Z kërkohet të përfaqësohen nga një avokat përpara një gjykate rrethi, § 78 I ZPO.



Rasti Studimor 7: Neni 11 – Rrëzimi i kërkesës

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Triestes

Faktet:

- A, me banim në Itali, lidh një marrëveshje kredie konsumatore për shumën prej 30.000 EUR me B, një bankë Sllovene, në mënyrë që të blejë një automjet. Kur A dështon të kryejë disa ripagime mujore, B gjykon se kontrata ka përfunduar dhe aplikon para gjykatës kompetente italiane për lëshimin e një urdhri evropian për pagesë kundër A për rimbursimin e kapitalit, plus interesat. Gjykata e refuzon aplikimin, duke lëshuar formularin D.
- **Skenari I:**
- Supozoni se gjykata e refuzon aplikimin, por nuk specifikon arsyet.
- **Pyetja 1:** A mundet B të paraqesë ankim kundër vendimit para gjykatës italiane?



Rasti Studimor 7: Neni 11 – Rrëzimi i kërkesës

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Triestes

- **Përgjigje 1:**
- Jo: në Itali, kjo nuk është e mundur. Megjithatë, vendet e tjera mund të lejojnë ankimin. Shikoni Recitalin (17) të Rregullores së UEP: “Nuk do të ketë të drejtë ankimi kundër refuzimit të aplikimit. Megjithatë, kjo nuk përjashton një rishikim të mundshëm të vendimit që rrëzon kërkesën në të njëjtin shkallë juridiksioni në përputhje me ligjin kombëtar”.



Rasti Studimor 7: Neni 11 – Rrëzimi i kërkesës

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Triestes

- **Skenari II:**
- Supozoni se gjykata e refuzon aplikimin sepse norma e interesave për pagesa të vonuara ishte caktuar në kontratë si e barabartë me 29% të shumës së detyrimit. Duke e konsideruar klauzolën të padrejtë sipas Direktivës 93/13 / KEE, gjykata italiane refuzon të lëshojë urdhrin.
- **Pyetja 2:** A është i ligjshëm vendimi?



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



Rasti Studimor 7: Neni 11 – Rrëzimi i kërkesës

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Triestes

- **Përgjigje 2:**
- Po: Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian, Banco Español de Crédito, SA v Joaquín Calderón Camino, Çështja C - 618/10.



Rasti Studimor 7: Neni 11 – Rrëzimi i kërkesës

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Triestes

- **Skenari III:**
- Supozoni se gjykata e refuzon aplikimin sipas nenit 11, shkronja (d), sepse aplikimi fillestar nuk ishte i plotë me të gjitha informacionet e kërkuara sipas nenit 7 të Rregullores UEP, dhe, pavarësisht kërkesës së gjykatës për të plotësuar aplikimin sipas nenit 9 të Rregullores UEP, B nuk dërgoi informacionin që mungonte brenda afatit të caktuar nga gjykata.
- **Pyetja 3:** A mund të paraqesë B një aplikim të ri?



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



Rasti Studimor 7: Neni 11 – Rrëzimi i kërkesës

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Triestes

- **Përgjigje 3:** Po: shiko nenin 11(3) të Rregullores UEP.



Rasti Studimor 8: Neni 14 – Njoftimi pa provë marrje nga i padituri dhe Neni 15 – Njoftimi i përfaqësuesit

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Triestes

Faktet:

- Duke përdorur formularin A të Rregullores UEP, A, një banor në Itali, aplikon përpara një gjykate italiane për lëshimin e një urdhri evropian për pagesë kundër B, i cili ka vendbanimin/selinë e tij në Francë. Gjykata kompetente italiane jep urdhrin evropian për pagesë kundër B, duke lëshuar formularin E.
- Megjënëse në Itali i takon palës kërkuese që t'i njoftojë dokumentet gjyqësore palës tjetër, A i njofton B-së formularët A dhe E.
- **Skenari I:**
- Supozoni se A i njofton B-së dy formularët ashtu sikurse janë, domethënë në gjuhën italiane.
- **Pyetja 1:** A është njoftimi efektiv?



Rasti Studimor 8: Neni 14 – Njoftimi pa provë marrje nga i padituri dhe Neni 15 – Njoftimi i përfaqësuesit

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Triestes

Përgjigje 1:

- Jo: neni 27 i Rregullores UEP parashikon shprehimisht se “kjo Rregullore nuk do të ndikojë në zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1348/2000”, tani e zëvendësuar nga Rregullorja KE Nr. 1393/2007. Sipas nenit 8 të Rregullores KE Nr. 1393/2007, kur njoftohet një akt gjyqësor, i cili nuk është i shkruar ose i shoqëruar nga një përkthim në gjuhën e marrësit ose në gjuhën zyrtare të Shtetit Anëtar të adresuar, autoriteti njoftues duhet të informojë të adresuarin se ai mund të refuzojë të pranojë dokumentin. Shih gjithashtu Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian, Catlin Europe SE v O. K. Trans Praha spol. s r o., 6 shtator 2018, çështja C-21/17.



Rasti Studimor 8: Neni 14 – Njoftimi pa provë marrje nga i padituri dhe Neni 15 – Njoftimi i përfaqësuesit

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Triestes

- **Skenari II:**
- Supozoni se B është një person fizik dhe:
- (i) dokumentet i dorëzohen personalisht B-së në vendin ku A di se ai është me vendbanim. Sidoqoftë, e panjohur për A, B nuk ka më vendbanim në atë adresë.
- **Pyetja 2:** A është njoftimi efektiv?
- (ii) dokumentet i njoftohen personalisht partnerit të B-së, në vendin ku banon B-ja.
- **Pyetja 3:** A është njoftimi efektiv?
- (iii) dokumentet njoftohen përmes postës elektronike në adresën e postës elektronike të B-së, me konfirmimin automatik të dorëzimit.
- **Pyetja 4:** A është njoftimi efektiv?
- (iv) dokumentet i njoftohen personalisht avokatit të B-së, i cili është i njohur për A-në.
- **Pyetja 5:** A është njoftimi efektiv?



Rasti Studimor 8: Neni 14 – Njoftimi pa provë marrje nga i padituri dhe Neni 15 – Njoftimi i përfaqësuesit

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Triestes

- **Përgjigje 2:** Jo: shih nenin 14 (1) të Rregullores UEP; Vendimi i Gjykatës (Dhoma e Tretë), 4 shtator 2014, Eco cosmetics GmbH & Co. KG dhe Raiffeisenbank St. Georgen reg. Gen. mbH kundër Virginie Laetitia Barbara Dupuy dhe Tetyana Bonchuk, Çështjet e Bashkuara C - 119/13 dhe C - 120/13.
- **Përgjigje 3:** Po, me kusht që kërkesat e nenit 14 (3) të Rregullores UEP të jenë përmbushur: shiko nenin 14 (1) (b) dhe 14 (3) të Rregullores UEP.
- **Përgjigje 4:** Jo, përveç kur B “e ka pranuar shprehimisht këtë metodë të njoftimit paraprakisht”: shiko nenin 14 (1) (f) të Rregullores UEP.
- **Përgjigje 5:** Po: shih nenin 15 të Rregullores UEP.



Rasti Studimor 8: Neni 14 – Njoftimi pa provë marrje nga i padituri dhe Neni 15 – Njoftimi i përfaqësuesit

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Triestes

- **Skenari III**
- Supozoni se B është person juridik dhe:
 - (i) dokumentet dërgohen nga shërbimi i zakonshëm postar në adresën e shoqërisë në selinë e saj zyrtare.
 - **Pyetja 6:** A është njoftimi efektiv?
 - (ii) dokumentet janë dërguar në zyrën postare të shoqërisë B.
 - **Pyetja 7:** A është njoftimi efektiv?
 - (iii) dokumentet i janë njoftuar personalisht CEO-s të shoqërisë B.
 - **Pyetja 8:** A është njoftimi efektiv?
 - (v) dokumentet i njoftohen personalisht menaxherit të shitjeve të shoqërisë B, i cili është kontakti kryesor i A-së.
 - **Pyetja 9:** A është njoftimi efektiv?



Rasti Studimor 8: Neni 14 – Njoftimi pa provë marrje nga i padituri dhe Neni 15 – Njoftimi i përfaqësuesit

Përgatitur nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Triestes

- **Përgjigje 6:** Jo: shih nenin 14 (1) (e) të Rregullores UEP.
- **Përgjigje 7:** Jo, përveç kur një njoftim me shkrim dërgohet gjithashtu në kutinë postare të debitorit duke informuar në lidhje me depozitimin e një dokumenti që është një dokument gjyqësor: shih nenin 14 (1) (d) të Rregullores UEP.
- **Përgjigje 8:** Po, me kusht që kërkesat e nenit 14 (3) të Rregullores UEP të jenë përmbushur: shih nenin 14 (1) (b) dhe (3) të Rregullores UEP.
- **Përgjigje 9:** Po, me kusht që kërkesat e nenit 14 (3) të Rregullores UEP të jenë përmbushur: shih nenin 14 (1) (b) dhe (3) të Rregullores UEP



Rasti Studimor 9: Nenet 24-33

Materiali u përgatit nga anëtarët e ekipit të projektit të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Mariborit

Faktet:

- Për të rimbursuar shumën e tij prej 25.000 EUR, një paditës A nga Spanja paraqiti para Gjykatës në Maribor (Slloveni) një aplikim për një urdhër evropian për pagesë ndaj të paditurit B nga Sllovenia.

Skenari I

- Në Slloveni juridiksioni *ratione materiae* përcaktohet sipas vlerës së padisë. Gjykatat lokale kanë juridiksion të gjykojnë dhe vendosin për padi për mosmarrëveshje pronësie, kur vlera e objektit në fjalë nuk i kalon 20.000 EURO. Gjykatat e distriktit kanë juridiksion të gjykojnë dhe vendosin për paditë për mosmarrëveshje pronësie, kur vlera e objektit në fjalë tejkalon 20.000 EURO.
- Në përputhje me nenin 29 të Rregullores (KE) Nr. 1896/2006 të 12 dhjetorit 2006, për krijimin e një urdhri evropian për procedurën e pagesës: “Shtetet Anëtare do t’i komunikojnë Komisionit, se cilat gjykata kanë juridiksion të nxjerrin Urdhër Evropian për Pagesa. Komisioni do t’i vendosë në dispozicion informacionet e njoftuara në përputhje me paragrafin 1 përmes publikimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe përmes çdo mjeti tjetër të përshtatshëm.” Ministria Sllovene e Drejtësisë i komunikoi Komisionit, që gjykatat lokale në Slloveni kanë juridiksion të lëshojnë një urdhër Evropian për pagesë.
- **Pyetja 1:** Cila gjykatë në Maribor ka juridiksion? Ajo lokale, apo ajo e distriktit?



Rasti Studimor 9: Nenet 24-33

Materiali u përgatit nga anëtarët e ekipit të projektit të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Mariborit

- **Përgjigje 1:**
- Njoftimi i Ministrisë Sllovene të Drejtësisë, që i është komunikuar Komisionit, se cila gjykatë ka juridiksion, nuk ishte i saktë. Edhe nëse njoftimi do të publikohej në pjesën jo normative të Gazetës Zyrtare të Bashkimit Evropian, gjykatësi slloven duhet të zbatojë Ligjin e procedurës civile Sllovene për të përcaktuar se cila gjykatë është kompetente. Prandaj, gjykata e distriktit ka juridiksion.



Rasti Studimor 9: Nenet 24-33

Materiali u përgatit nga anëtarët e ekipit të projektit të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Mariborit

Skenari II

- Urdhri evropian për pagesë i ishte dërguar të paditurit B në 10 korrik 2019. Në Slloveni, sipas nenit 83 të Ligjit të Gjykatave “në periudhën ndërmjet 15 korrikut dhe 15 gushtit (pushimet në gjyqësor), gjykatat do të zhvillojnë seanca gjyqësore dhe do të marrin vendime vetëm në çështje urgjente.”
- **Pyetja 2:** Deri në cilën datë i padituri duhet të dërgojë deklaratën për kundërshtimin e një urdhri evropian për pagesë?



Rasti Studimor 9: Nenet 24-33

Materiali u përgatit nga anëtarët e ekipit të projektit të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Mariborit

- **Përgjigje 2:**
- Paragrafi i dytë i nenit 16 të Rregullores (KE) nr. 1896/2006: “Deklarata e kundërshtimit dërgohet brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të urdhrit evropian për pagesë të paditurit.”
- Recitali 28 i Rregullores nr. 1896/2006: “Për qëllime të llogaritjes së afateve kohore, duhet të zbatohet Rregullorja (KEE, Euratom) nr. 1182/71 e Këshillit e 3 qershorit 1971, që përcakton rregullat e zbatueshme për periudhat, datat dhe afatet kohore.”
- Sipas kësaj rregulloreje, mbyllja e gjykatave për arsye të pushimeve zyrtare, nuk ndikon në vijimin e afateve.
- Neni 3 i Rregullores nr. 1182/71: “Kur një afat është caktuar në ditë, javë, muaj ose vite do të llogaritet nga momenti në të cilin ndodh një ngjarje ose kryhet një veprim, por do të përjashtohet dita gjatë së cilës ndodh ajo ngjarje ose që kryhet veprimi.”
- Si pasojë, i padituri ka kohë të dërgojë deklaratën e kundërshtimit deri më 9 gusht 2019.



Rasti Studimor 9: Nenet 24-33

Materiali u përgatit nga anëtarët e ekipit të projektit të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Mariborit

Skenari III

- I padituri B nga Sllovenia ka si qëllim të dërgojë deklaratën e kundërshtimit ndaj një Urdhri Evropian për Pagesë me ndihmën e një avokati ose një profesionisti tjetër ligjor. Sipas Ligjit të procedurës civile sllovene, në procedurat e zhvilluara nga gjykatat e distriktit, vetëm një avokat ose një person tjetër, që ka kaluar provimin shtetëror gjyqësor, mund të veprojë si avokat.
- **Pyetje 3:** A duhet që përfaqësuesi i të paditurit B nga Sllovenia të jetë një avokat ose një person tjetër, që ka kaluar provimin shtetëror mbi gjyqësorin, apo kjo bie ndesh me dispozitat e Rregullores 1896/2006?



Rasti Studimor 9: Nenet 24-33

Materiali u përgatit nga anëtarët e ekipit të projektit të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Mariborit

- **Përgjigje 3:**
- Ligji i procedurës civile slllovene nuk bie në kundërshtim me nenin 24 të Rregullores nr. 1896/2006. Përfaqësimi nga një avokat ose një profesionist tjetër ligjor ende nuk është i detyrueshëm. Kjo dispozitë përcakton vetëm se kush mund të jetë përfaqësues përpara gjykatës.



Rasti Studimor 9: Nenet 24-33

Materiali u përgatit nga anëtarët e ekipit të projektit të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Mariborit

Skenari IV

- I padituri B nga Sllovenia, më në fund, merr avokatin e tij.
- **Pyetja 4:** Si duhet të paraqesë i padituri në gjykatë një prokurë të posaçme? A duhet të zbatohet ligji i vendit?



Rasti Studimor 9: Nenet 24-33

Materiali u përgatit nga anëtarët e ekipit të projektit të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Mariborit

- **Përgjigje 4:**
- As Rregullorja nr. 1896/2006 dhe as formulari A i Rregullores 1896/2006, nuk rregullojnë mënyrën e paraqitjes në gjykatë të një prokure të posaçme. Informacioni në lidhje me përfaqësuesit e palëve duhet të specifikohet në formularin A. Si pasojë, kjo nuk është një çështje kur neni 26 - të gjitha çështjet procedurale, që nuk parashikohen në mënyrë specifike në Rregulloren 1896/2006 do të rregullohen me ligjin vendës- duhet të zbatohet.



Rasti Studimor 9: Nenet 24-33

Materiali u përgatit nga anëtarët e ekipit të projektit të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Mariborit

Skenari V

- Urdhri evropian për pagesë është shpallur i zbatueshëm. I padituri B mendon se urdhri nuk është njoftuar në atë mënyrë që përputhet me standardet minimum të Rregullores 1896/2006.
- **Pyetje 5:** A ka ndonjë mundësi B për të pretenduar parregullsinë e këtij urdhri?
- **Pyetje 6:** Cila rregullore zbatohet në lidhje me njoftimin e urdhrit evropian për pagesa në raste ndërkufitare?



Rasti Studimor 9: Nenet 24-33

Materiali u përgatit nga anëtarët e ekipit të projektit të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Mariborit

- **Përgjigje 5:** Vendimi i Gjykatës në çështjet e bashkuara C - 119/13 dhe C - 120/13, Eko Kozmetikë GmbH & Co. KG kundër Virginie Laetitia Barbara Dupuy (C - 119/13), dhe Raiffeisenbank St. Georgen reg. Gen. mbH v Tetyana Bonchyk (C - 120/13), ECLI: BE: C: 2014: 2144, paragrafi 45-48:
- Në çdo rast, duhet të theksohet se, në bazë të nenit 26 të Rregullores nr. 1896/2006, çdo çështje procedurale, që nuk parashikohet në mënyrë specifike në rregullore “do të rregullohet nga ligji vendës”. Kur është ky rasti, përjashtohet në përputhje me rrethanat zbatimi me analogji i Rregullores. Në rastin konkret, Rregullorja nr. 1896/2006 nuk shprehet për sa i përket mjeteve juridike të mundshme në dispozicion të të paditurit vetëm në qoftëse shfaqet pasi një urdhër evropian për pagesë është shpallur i ekzekutueshëm, që urdhri nuk është njoftuar në atë mënyrë, që përputhet me standardet minimum të përcaktuara në nenet 13 deri 15 të kësaj rregulloreje. Nga kjo rrjedh se në një rast të tillë, ato çështje procedurale rregullohen nga ligji vendës, në përputhje me nenin 26 të Rregullores nr. 1896/2006.
- Në çdo rast, duhet të theksohet se kur një Urdhër Evropian për Pagesë nuk është dërguar në një mënyrë që përputhet me standardet minimale të përcaktuara në nenet 13 deri në 15 të Rregullores nr.1896/2006, nuk mund të përfitojë nga zbatimi i procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm të përcaktuar në nenin 18 të saj. Nga kjo rrjedh se deklarata e ekzekutimit për një urdhër të tillë pagesë duhet të konsiderohet e pavlefshme.



Rasti Studimor 9: Nenet 24-33

Materiali u përgatit nga anëtarët e ekipit të projektit të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Mariborit

- **Përgjigje 6:**
- Neni 27 i Rregullores Nr 1896/2006: “Kjo Rregullore nuk do të ndikojë në zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1348/2000 të 29 majit 2000, për njoftimin në Shtetet Anëtare të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në çështjet civile dhe tregtare”
- Paragrafi i dytë i nenit 25 të Rregullores (KE) Nr. 1393/2007 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian i datës 13 Nëntor 2007, për njoftimin në Shtetet Anëtare të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në çështjet civile ose tregtare (njoftimi i dokumenteve) dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1348/2000:
- Referencat e bëra në Rregulloren e shfuqizuar do të interpretohen si të bëra kësaj Rregulloreje dhe duhet të lexohen në përputhje me tabelën përkatëse në Shtojcën III.



Rasti Studimor 10: Nenet 24-33

Materiali u përgatit nga anëtarët e ekipit të projektit të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Mariborit

Faktet:

- Muajin e kaluar, A që banon në Slloveni përktheu një dokument për B-në, i cili banon në Hannover, Gjermani. Kostoja totale e punës vlerësohet në 7.500 Euro. A-ja i ka dërguar faturën, por nuk ka marrë përgjigje nga B-ja.

Skenari I:

- A-ja po mendon të paraqesë një urdhër evropian për pagesë (Formulari A), por ka frikë pasi ajo nuk flet gjermanisht, nuk ka para për të paguar një avokat e as tarifatat gjyqësore.
- **Pyetja 1:** A ka nevojë A-ja për një avokat, apo ajo mund ta paraqesë vetë Formularin A?
- **Pyetja 2:** Po sikur A nuk mund të procedojë me tarifatat e Gjykatës? A mund të paguajë dikush për të?
- **Pyetje 3:** Si do të veprojë A-ja ndaj problemit të mosnjohjes së gjuhës?



Rasti Studimor 10: Nenet 24-33

Materiali u përgatit nga anëtarët e ekipit të projektit të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Mariborit

- **Përgjigje 1:** A-ja nuk ka nevojë për avokat. Ajo mund ta paraqesë vetë Formularin A.
- **Përgjigje 2:** Neni 25 (2) i Rregullores Nr. 1896/2006 “Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, tarifat gjyqësore përfshijnë tarifat dhe shpenzimet gjyqësore që duhet t’i paguhen Gjykatës, shuma e të cilave është caktuar në përputhje me ligjin e shtetit”
- Në Slloveni, tarifat gjyqësore rregullohen nga Ligji për Tarifat e Gjykatës. Siç përcaktohet në nenin 3 të Ligjit për Tarifat e Gjykatës (ZST-1), është me të vërtetë tatimpaguesi që paguan tarifën gjyqësore për propozimin e fillimit të procedurave ose kryerjen e një akti të vetëm procedural (për çështjet civile). Megjithatë, kjo dispozitë nuk duhet të interpretohet kaq ngushtë, që vetëm një tatimpagues i tillë mund të paguajë vetë tarifën; domethënë që nuk mund të paguhet nga një tjetër. Neni 105.a i Ligjit të Procedurës Civile (ZPP), nuk përcakton shprehimisht që tatimpaguesi duhet të paguante tarifën. **Si pasojë, nuk ka asnjë pengesë që një palë e tretë të jetë në gjendje të paguajë tarifën gjyqësore** për një tatimpagues të tillë dhe që një pagesë e tillë të konsiderohet se i ka paguar tatimpaguesit një tarifë të caktuar për këtë shkak.
- **Përgjigje 3:** Kërkuesit mund t’i kërkohej të paraqesë një kopje të UEP, në një gjuhë të ndryshme nga ajo e përdorur nga Gjykata e origjinës. Si rregull i përgjithshëm, UEP duhet të sigurohet në gjuhën zyrtare, ose në një të tjetër nga gjuhët zyrtare, të Shtetit Anëtar të zbatimit, përveç nëse ai Shtet Anëtar ka treguar që ai do të pranojë urdhra në një gjuhë tjetër ose gjuhë zyrtare të Bashkimit Evropian. Çdo përkthim do të vërtetohet nga një person i kualifikuar për ta bërë këtë në një nga Shtetet Anëtare (Përkthim Neni 21 (2) (b)).



Rasti Studimor 11: Nenet 24-33

Materiali u përgatit nga anëtarët e ekipit të projektit të Universitetit të Mariborit

Faktet:

- Një shoqëri sllovene lëshoi një UEP (Formulari A) të një shume prej 22.000 Euro për një shoqëri suedeze, që kundërshtoi të paguante (Formulari F). Pas procedurave civile, Gjykata e Distriktit, e cila ka lëshuar UEP (Formularin E) ngarkoi A-në për të paguar një shumë më të lartë se për procedurat e zakonshme civile, për shkak të stresit dhe vështirësisë në lidhje me çështjen.
- **Pyetje 1:** A është i saktë vendimi i Gjykatës, për të ngarkuar A-në më shumë, për tarifatat e kombinuara gjyqësore për procedurën e urdhrimit evropian për pagesë dhe procedurat e zakonshme civile, për shkak të Formularit F?
- **Pyetje 2:** A mundet A-ja të refuzojë për të paguar pas procesit civil (në Slloveni)?



Rasti Studimor 11: Nenet 24-33

Materiali u përgatit nga anëtarët e ekipit të projektit të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Mariborit

- **Përgjigje 1:** Vendimi i Gjykatës nuk është i saktë. (Shiko Nenin 25 të Rregullores nr. 1896/2006)
- **Përgjigje 2:** A-ja mund të refuzojë të paguajë. Në përputhje me parashikimin e paragrafit të pestë të “Ligjit mbi Tarifat e Gjykatës” (këtu e tutje ZST-1), një urdhër pagese mund të kundërshtohet për dy arsye: tarifa është paguar tashmë ose që **Gjykata ka vlerësuar gabim tarifën.**
- Çështje e lidhur: Çështja C - 215/11, Iwona Szyrocka v SiGer Technologie GmbH, Gjykata (Dhoma e Parë) vendosi: “Sipas Nenit 25 (të Rregullores (KE) nr. 1896/2006) dhe sipas kushteve të përcaktuara në atë nen, një gjykatë vendase mund të përcaktojë vlerën e tarifës gjyqësore vetëm sipas rregullave të përcaktuara nga ligji vendës, me kusht që ato rregulla nuk janë më pak të favorshme sesa ato që rregullojnë situata të ngjashme në ligjin vendës dhe nëse ato në praktikë nuk pengojnë ose nuk e pengojnë padrejtësisht ushtrimin e të drejtave të dhëna nga ligji i Unionit”.



Rasti Studimor 12: Ndërveprimi i konceptit ligjor të 'konsumatorit' dhe Urdhrit Evropian për Pagesë

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit të UDC

Faktet:

- Në Janar 2017, shoqata ndërkombëtare Amigos de lo ajeno, me adresë të regjistruar në qytetin A Coruña (Spanjë), vendosi të rinovojë një pronë zyre, që i përket shoqatës në qytetin e Dortmund (Gjermani). Pasi shqyrtoi kuotime të ndryshme për punën, shoqata vendosi të lidhë kontratën për punën me një kompani franceze, Demolombe, SARL, e cila ka një histori të gjatë në sektorin e ndërtimit. Kontrata për punën nuk përfshinte materialet e dyshemesë që kërkoheshin, të cilat u morën direkt nga një shoqëri italiane, 'Cavi di Titanus, SRL'. Tani që puna ka mbaruar, shoqata ka fatura të papaguara për pagimin e të dy shoqërive në vlerën prej 5000 € secila. Shoqëritë po ndërmarrin veprime ligjore për të kërkuar borxhet e tyre përkatëse të papaguara, duke përdorur procedurën e urdhërit evropian për pagesë.
- **Pyetja 1:** Cila gjykatë ka juridiksion për të vendosur mbi çështjen?



Rasti Studimor 12: Ndërveprimi i konceptit ligjor të 'konsumatorit' dhe Urdhrit Evropian për Pagesë

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit të UDC

- **Përgjigje 1:**
- Neni 6 i Rregullores (KE) nr. 1896/2006 shprehet se juridiksioni, për pjesën më të madhe, përcaktohet në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 44/2001 dhe më pas në përputhje me Rregulloren e rishikuar (BE) nr. 1215/2012.
- Neni 6, paragrafi 2 gjithashtu parashikon raste kur kërkesa lidhet me një kontratë të lidhur nga një konsumator dhe i padituri është konsumatori. Në raste të tilla, juridiksioni korrespondon me gjykatat në Shtetin Anëtar në të cilin ndodhet i padituri.
- Pyetja në këtë rast është se si të përcaktohet koncepti i konsumatorit dhe nëse një shoqatë - një person juridik - a mund të konsiderohet e tillë, sipas nenit 6 të Rregullores UEP.
- Nëse shoqata Amigos de lo ajeno mund të konsiderohet një 'konsumator' sipas Rregullores, atëherë vetëm gjykata e shkallës së parë ku banon i padituri (A Coruña) do të ketë juridiksion për të gjykuar pretendimet e bëra kundër saj, nga Demolombe, SARL dhe Cavi di Titanus, SRL, në përputhje me nenin 813 të Ligjit të Procedurës Civile 1/2000 (7 Janar). Nëse shoqata nuk konsiderohet si një konsumator, atëherë, në përputhje me nenin 6 të Rregullores UEP, do të zbatohet neni 7 (1) i Rregullores së Brukselit I bis dhe gjykata me juridiksion për të shqyrtuar çdo pretendim në lidhje me shitjen e mallrave dhe/ose shpërndarjen e shërbimeve, do të jetë në përputhje me procedurat ligjore në fuqi në Gjermani, si vendi në të cilin janë dorëzuar mallrat dhe janë kryer shërbimet e kontraktuara të rinovimit.
- Nga pikëpamja e sistemit juridik spanjoll, personat juridikë, përfshirë shoqatat, janë shprehimisht të përfshira në përkufizi min ligjor prima facie të një konsumatori.
- Prandaj, mund të argumentohet se mbrojtjet e parashikuara në ligj për personat fizikë në cilësinë e tyre si konsumatorë mund të shtrihen në personat juridikë dhe organizatat e pa regjistruara në një nivel evropian, megjithëse me disa kufizime dhe masa mbrojtëse. Praktika gjyqësore e GJDBE-së në lidhje me konceptin e konsumatorit, për shembull, ka treguar një evolucion pozitiv në këtë drejtim, nga një përkufizim fillimisht më kufizues (C-269/95, Benincasa, BE: C: 1997: 337), në një të përqendruar, më shumë në kontekstin objektiv të mënyrës së veprimit sesa në personalitetin juridik ose kushtet subjektive të palës kontraktuese (C-110/14, Costea, BE: C: 2015: 538; C-630/17, Milivojević, BE: C: 2019 : 123).
- GJDBE gjithashtu ka bërë të qartë se asgjë nuk i ndalon Shtetet Anëtare të zgjerojnë harmonizimin e pjesëshëm të të drejtave të konsumatorit në disa fusha për subjekte të tjera (subjekte juridike dhe madje edhe organizata të pa regjistruara), me kusht që fryma e sistemit evropian të mbrojtjes së konsumatorit të mos kompromentohet (C-329/19, Condominio di Milano, përmes Meda, BE: C: 2020: 263).



Rasti Studimor 13

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit të UDC

Faktet:

- María, një shtetase spanjolle që banon në Zamora, pranon t'i shesë automjetin e saj tip Audi A4, Manuelit, një Portugez me vendbanim në Oporto. Ata të dy takohen çdo vit gjatë pushimeve në qytetin portugez, Viana do Castelo, ku jetojnë prindërit e Manuelit dhe María merr me qira një apartament pushimesh. Në verën e vitit 2018, María i përmend Manuelit se po përpiqet të shesë automjetin e saj dhe Manueli shpreh interes për ta blerë atë. Ata bien dakord atje për një çmim (3500 €) dhe më pas ata nënshkruajnë një kontratë shitblerjeje për automjetin në gusht 2018 në Viana do Castelo. Menjëherë pas kësaj María ia dorëzon automjetin Manuelit dhe Manuel paguan një këst fillestar të çmimit të blerjes së rënë dakord (2000 €), duke marrë përsipër për të paguar pjesën e mbetur (1500 €) në dhjetor të të njëjtit vit.
- Në shtator, Manuel humbet punën e tij dhe për pasojë nuk është në gjendje të bëjë pagesën e mbetur për automjetin që bleu. Pas disa kërkesave për pagimin e shumës së papaguar, María vendos të kërkojë një urdhër evropian për pagesë në gjykatën e shkallës së parë në Zamora, duke përfshirë në kërkesën e saj adresën e prindërve të Manuel në Viana de Castelo, ku ajo e di që Manuel jeton në atë kohë. Gjykata lëshon një urdhër pagese në emër të Manuelit pa vërtetimin e marrjes.



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



Rasti Studimor 13

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit të UDC

- **Pyetja 1:** Cila gjykatë ka juridiksion për të vendosur mbi çështjen?
- **Pyetje 2:** VENDI DHE MËNYRA E NJOFTIMIT?



Rasti Studimor 13

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit të UDC

- **Përgjigje 1:**
- Rregullorja 1896/2006 krijon forumin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në favor të konsumatorit. Klauzola e përzgjedhjes së forumit në nenin 6 mbron konsumatorin/en e paditur duke caktuar si gjykatë me juridiksion, atë ku ai/ajo ka vendbanimin e tij/saj. Megjithatë, dispozita nuk zbatohet në këtë rast, meqenëse María është një individ privat, jo një tregtar dhe marrëveshja midis saj dhe Manuelit është një marrëveshje shitblerje civile, jo një kontratë konsumatori.
- Nëse blerja do të mbulohej nga një kontratë konsumatori, juridiksioni për të gjykuar padinë e Marías do ti përkiste gjykatës në Oporto.
- Sipas nenit 4 të Rregullores 44/2001, juridiksioni në çështjet civile dhe tregtare lidhet me vendin në të cilin dorëzohen mallrat, i cili në këtë rast ishte Viana do Castelo, kështu që juridiksioni për të gjykuar padinë e Marías do t'i përkiste gjykatës së Viana Castelo.
- Në asnjë rrethanë juridiksioni nuk do t'i përkiste gjykatës së shkallës së parë në Zamora, ku María bëri kërkesën e saj.



Rasti Studimor 13

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit të UDC

- **Përgjigje 2:**
- Mënyra me të cilën është dorëzuar urdhërpagesa (me anë të një letre, përmes postës së zakonshme, dorëzuar direkt në kutinë postare të të paditurit pa vërtetimin e marrjes) është një nga metodat e pranuar sipas Rregullores 1896/2006 në kuadër të shpejtësisë dhe efikasitetit. Për të siguruar që i padituri e merr urdhrin, si pasojë, ajo duhet të dorëzohet në adresën e shtëpisë së tij/saj.
- Ky nuk është rasti, sepse në këtë moment i padituri është me vendbanim në Oporto, jo në Viana.
- Për shkak se mënyra e njoftimit e dhënë në nenin 14 (pa vërtetimin e marrjes) është më pak e besueshme, ligji i BE-së parashikon gjithashtu masa për të paditurit që njoftohen në këtë mënyrë, kur njoftimi nuk kryhet në kohë, duke lejuar që i padituri në raste të tilla të kërkojë një rishikim të procedurave në përputhje me afatet dhe kushtet e parashikuara në nenin 20. Për të filluar procesin e rishikimit, të paditurit nuk i kërkohet të tregojë prova se ai / ajo nuk është njoftuar, por vetëm që urdhri është dorëzuar duke përdorur metodën e parashikuar në nenin 14.



Rasti Studimor 14: Mobiljet e Zyrave Gjermane

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit, Uppsala: Eric Bylander dhe Marie Linton

Faktet:

- Z. Grönlund, një shtetas suedez, me vendbanim në qytetin piktoresk mesjetar të Sigtuna (në afërsi të Stokholmit) është një konsulent ligjor në firmën e tij (Grönlund Juridik AB, që këtu e më tutje Grönlund). Zakonisht Z. Grönlund punon në zyrën e tij në qendër të qytetit të Sigtuna. Për shkak të distancimit fizik gjatë pandemisë së Covid-19, ai punon nga shtëpia e tij verore në arkipelagun e Stokholmit që nga marsi i vitit 2020. Pak përpara se të zhvendosej, ai porositi disa mobilje ekskluzive zyre për firmën e tij nga prodhuesi gjerman Schmittl Büromöbel Produktions- und Vertriebs GmbH në Dyseldorf, Nordrhein -Westfalen. Shuma totale që duhet të paguhet pas dorëzimit është 24 000 €. Mobiljet dorëzohen sipas kërkesës. Megjithatë, z. Grönlund harron gjithçka rreth faturës gjermane. Pas dy muajsh, shoqëria gjermane paraqet një kërkesë për një urdhër evropian për pagesë në një gjykatë në Düsseldorf. Gjykata lëshon një urdhër evropian për pagesë.



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



Rasti Studimor 14: Mobiljet e Zyrave Gjermane

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit, Uppsala: Eric Bylander dhe Marie Linton

- **Pyetje 1:** A mundet që urdhri evropian për pagesë të ekzekutohet në Suedi kundrejt Grönlund Juridik AB (Grönlund)? Nëse po, si? Nëse jo, pse?



Rasti Studimor 14: Mobiljet e Zyrave Gjermane

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit, Uppsala: Eric Bylander dhe Marie Linton

- **Përgjigje 1:** Çështja e ekzekutimit rregullohet në Rregulloren (KE) Nr. 1896/2006. Kjo rregullore është një alternativë ndaj procedurave të parashikuara nga ligji vendës ose procedurave të parashikuara nga Rregullorja (BE) Nr. 1215/201. Sipas neneve 2, 3 dhe 4 të Rregullores UEP kjo është një padi ndërkuftare civile dhe tregtare për një shumë specifike që është bërë e kërkueshme në kohën kur paraqitet kërkesa për një urdhër evropian për pagesë. Lidhur me çështjen zbatimit në kohë, neni 33 paragrafi i dytë i Rregullores së UEP thotë se ajo zbatohet nga 12 dhjetori 2008
- Nëse Grönlund nuk paraqet një deklaratë kundërshtimi në përputhje me nenin 16 (1) (duke përdorur formularin standard F siç përcaktohet në Aneksin VI të Rregullores) brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 16 (2) të Rregullores UEP, duke marrë parasysh një periudhë të përshtatshme kohore që lejon një deklaratë të mbërrijë, gjykata gjermane e origjinës, pa vonesë, do të deklarojë urdhrin evropian për pagesë të zbatueshëm sipas nenit 18 (1) të Rregullores së UEP. Kërkesat formale për ekzekutim rregullohen nga ligji gjerman, si ligji i Shtetit Anëtar të origjinës. Gjykata gjermane deklaron urdhrin evropian për pagesë të ekzekutueshëm duke përdorur Formularin G .
- Pasi gjykata gjermane të ketë deklaruar urdhrin evropian për pagesa të ekzekutueshëm, ai do të njihet dhe ekzekutohet në Suedi, ose në ndonjë Shtet Anëtar tjetër për atë çështje, pa ndonjë nevojë për një deklaratë për ekzekutim dhe pa ndonjë mundësi të kundërshtimit të njohjes së saj sipas nenit 19 të Rregullores së UEP.



Rasti Studimor 14: Mobiljet e Zyrave Gjermane

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit, Uppsala: Eric Bylander dhe Marie Linton

- **Përgjigje 1: -vijim**
- Për të zbatuar urdhrin evropian për pagesë në Suedi, shoqëria gjermane duhet të bëjë kërkesë tek autoritetet suedeze të ekzekutimit, cf. neni 21 (1). (Në Suedi, ka vetëm një autoritet ekzekutimi, Kronofogdemyndigheten.) Neni 21 (2) i Rregullores UEP specifikon që kërkuesi duhet të mundësojë një kopje të urdhrin evropian për pagesë, të deklaruar të ekzekutueshëm nga gjykata Gjermane e origjinës, e cila plotëson kushtet e nevojshme për të vërtetuar autenticitetin e tij. Kur është e nevojshme, urdhri evropian për pagesë do të përkthehet në një gjuhë të pranuar në Suedi. Autoriteti suedez i ekzekutimit do të pranojë përkthime në suedisht ose anglisht. Asnjë mjet sigurimi, obligacion ose depozitë nuk mund të kërkohet në Suedi, nga pretenduesi gjerman vetëm sepse është i huaj, shih nenin 21 (3). Në këtë pikë, parimi i BE-së i mos-diskriminimit është i perceptueshëm.
- Ekzekutimi aktualisht i urdhrin evropian për pagesa rregullohet nga ligji i Shtetit Anëtar ekzekutues, d.m.th. nga ligji Suedez, sipas neni 21 (1) paragrafi i parë. Megjithatë, rregullat suedeze mund të mos jenë në kundërshtim me procedurën e ekzekutimit në Rregullore (shih nenet 22 dhe 23 të Rregullores UEP). Neni 21 (1) paragrafi i dytë i Rregullores UEP nënvizon faktin se një urdhër evropian për pagesë, i cili është bërë i ekzekutueshëm, do të zbatohet nën të njëjtat kushte si një vendim i ekzekutueshëm i lëshuar në Shtetin Anëtar të ekzekutimit, dmth urdhri evropian për pagesë do të ekzekutohet në të njëjtën mënyrë si një vendim suedez.



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



Rasti Studimor 14: Mobiljet e Zyrave Gjermane

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit, Uppsala: Eric Bylander dhe Marie Linton

Skenari I:

- Grönlund gjithashtu ka pasuri në Danimarkë.
- **Pyetja 2:** A mundet që urdhri evropian për pagesë të ekzekutohet në Danimarkë kundër Grönlund sipas Rregullores UEP?



Rasti Studimor 14: Mobiljet e Zyrave Gjermane

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit, Uppsala: Eric Bylander dhe Marie Linton

- **Përgjigje 2:** Rregullorja zbatohet për të gjitha Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, përveç Danimarkës. Sipas nenit 2 (3) të Rregullores së UEP, termi “Shtet Anëtar” do të thotë Shtetet Anëtare, me përjashtim të Danimarkës. Arsyeja shpjegohet në recitalin 32 të Preambulës së Rregullores së UEP-it.
- Në përgjithësi, kur bëhet fjalë për zbatimin e vendimeve në Danimarkë, duhet të përdoren mënyra të tjera, ose duke përdorur ligjin e shtetit danez ose më së shumti duke përdorur Rregulloren e Brukselit I.



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



Rasti Studimor 14: Mobiljet e Zyrave Gjermane

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit, Uppsala: Eric Bylander dhe Marie Linton

- **Skenari II:**
- Në kohën kur urdhri evropian për pagesë është dorëzuar në Grönlund, fatura është paguar tashmë.
- **Pyetja 3:** A do të ekzekutohet akoma urdhri evropian për pagesë në Suedi kundër Grönlund?



Rasti Studimor 14: Mobiljet e Zyrave Gjermane

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit, Uppsala: Eric Bylander dhe Marie Linton

- **Përgjigje 3:**
- Sipas nenit 22 (2) të Rregullores së UEP-së, ekzekutimi i UEP-së, me kërkesë të të paditurit, do të refuzohet nga gjykata kompetente në Shtetin Anëtar të ekzekutimit, nëse dhe në masën që i padituri i ka paguar paditësit shumën e dhënë në urdhrin evropian për pagesë. Duke qenë se fatura është paguar, urdhri evropian për pagesë do të refuzohet të ekzekutohet në Suedi sipas nenit 22 (2).
- Rregullorja nuk përmban ndonjë dispozitë se si do të veprojë i padituri, në mënyrë që të kundërshtojë ekzekutimin. Kjo pyetje i është lënë ligjit vendës, në këtë rast ligjit suedez, cf. neni 21 (1).
- Koncepti “gjykatë” në nenin 5(3) të Rregullores së UEP-së përfshin gjithashtu autoritete të tjera të përfshira në zbatimin brenda kornizës së Rregullores UEP. Në disa Shtete Anëtare, të tilla si Suedia, kjo do të thotë që një kërkesë mund t’i paraqitet një autoriteti përmbarues në vend të një gjykate.



Rasti Studimor 14: Mobiljet e Zyrave Gjermane

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit, Uppsala: Eric Bylander dhe Marie Linton

Skenari III:

- Grönlund ka filluar procedura kundër kompanisë gjermane në Danimarkë për të mbrojtur pasuritë e vendosura atje. Një gjykatë daneze ka dhënë një vendim deklarativ përpara se kompania gjermane të paraqesë kërkesën për një urdhër evropian për pagesë. Sipas gjykimit danez, Grönlund nuk është i detyruar që t'i paguajë faturën kompanisë gjermane.
- **Pyetja 4:** Në këtë situatë, a mundet që urdhri evropian për pagesë të zbatohet ende në Suedi?



Rasti Studimor 14: Mobiljet e Zyrave Gjermane

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit, Uppsala: Eric Bylander dhe Marie Linton

- **Përgjigje 4:** Kjo është një pyetje e vështirë, potencialisht përfshin dy vendime të papajtueshme. Neni 22 (1) i Rregullores së UEP adreson çështjen.
- Urdhri evropian për pagesë mund të refuzohet të ekzekutohet në Suedi, nëse është i papajtueshëm me një vendim ose urdhër të mëparshëm të dhënë më parë në një Shtet Anëtar tjetër ose në një vend të tretë (si Danimarka është në lidhje me Rregulloren UEP), që përfshin të njëjtin shkak të padisë, midis të njëjtave palë. Shprehja “vendim ose urdhër” duhet të kuptohet që përfshin të gjitha format e vendimeve, vendimet gjyqësore, etj., për sa kohë që ato përmbushin kushtet e nevojshme për njohjen në Shtetin Anëtar të ekzekutimit = Suedi.
- Shkaku i refuzimit presupozon tre kushte për zbatimin e saj: vendimi i gjykatës daneze duhet të ketë të njëjtin shkak padie, të jetë midis të njëjtave palë, vendimi i gjykatës daneze duhet të përmbushë kushtet e nevojshme për njohjen e tij në Suedi (vendimi danez ka shumë të ngjarë të njihet në Suedi sipas marrëveshjes daneze të vitit 2005 dhe regjimit të Brukselit) dhe, papajtueshmëria nuk mund të ngrihej si kundërshtim në procedurat gjyqësore në Gjermani (mund të argumentohet se ky është rasti pasi vendimi danez ishte dhënë para dorëzimit të kërkesës për një urdhër evropian për pagesë në gjykatën gjermane).



Rasti Studimor 15: Portat e Mbyllura të Kopshtit të Edenit

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit, Uppsala: Eric Bylander dhe Marie Linton

Faktet:

- Znj. Edén, një shtetase suedeze, është pronare e një kopshti të jashtëzakonshëm në lindje të Skåne, provinca më jugore e Suedisë. Njerëzit vijnë nga larg dhe afër për të vizituar Kopshtin e Edenit. Për një kohë të gjatë, Shoqëria Hortikulturore e Polonisë Veriore (këtu e tutje HSNP) ka planifikuar një turne në Skåne, duke përfshirë një ditë të plotë në kopshtin e famshëm. Megjithatë, kur mbërrijnë në 12 Prill, 2020, portat janë të mbyllura. Pavarërisht parapagimit të 11 500 € për tarifën e hyrjes, tre turne të ndryshme me guida, dreka, workshope mbi lulet dhe darka të këndshme, askush nuk u ka thënë që kopshti është mbyllur për shkak të pandemisë Corona. Ky mesazh ju komunikua atyre vetëm me anë të një letre të vogël njoftimi në portat. Zonja Edén nuk u përgjigjet telefonatave ose postës elektronike nga HSNP. Katër javë pas kthimit në Poloni, HSNP aplikon në një gjykatë në Gdańsk për një urdhër evropian për pagesë për të rimarrë tarifën. Gjykata lëshon një urdhër evropian për pagesë kundrejt znj. Edén. Ajo nuk bën asnjë kundërshtim ndaj tij. Pas dy muajsh, gjykata polake shpall urdhrin evropian për pagesë të ekzekutueshëm.



Rasti Studimor 15: Portat e Mbyllura të Kopshtit të Edenit

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit, Uppsala: Eric Bylander dhe Marie Linton

- **Skenari I:**
- Kur urdhri evropian për pagesë i dorëzohet Znj. Edén, ajo pretendon se ishte penguar të kundërshtonte kërkesën për shkak të situatës së Coronas.
- **Pyetja 1:** Çfarë mund të bëjë zonja Edén?
- **Pyetja 2:** Cilat janë pasojat ligjore për znj. Edén, nëse gjykata polake vendos që rishikimi justifikohet dhe anasjelltas, nëse gjykata polake refuzon kërkesën për rishikim?



Rasti Studimor 15: Portat e Mbyllura të Kopshtit të Edenit

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit, Uppsala: Eric Bylander dhe Marie Linton

- **Përgjigje 1:** Vendimi nga gjykata në Gdańsk, Poloni, për të deklaruar të ekzekutueshëm urdhrin evropian për pagesë, nuk mund të ankimohet ose rishikohet. Megjithatë, e drejta e rishikimit parashikohet në nenin 20 të Rregullores UEP, në raste të jashtëzakonshme.
- Qëllimi i nenit 20 nuk është që t'i sigurojë të paditurit një “shans të dytë” për të kundërshtuar kërkesën, shih Recitalin (25) të Preambulës së Rregullores UEP.
- Zbatimi kufizues i nenit 20 të Rregullores UEP është për shkak të faktit se është një shmangie nga parimet e njohjes së ndërsjelltë të vendimeve gjyqësore dhe qarkullimit të lirë të vendimeve në Bashkimin Evropian. Prandaj, jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë konfirmon që neni 20 i Rregullores UEP do të zbatohet në mënyrë të kufizuar.



Rasti Studimor 15: Portat e Mbyllura të Kopshtit të Edenit

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit, Uppsala: Eric Bylander dhe Marie Linton

- **Përgjigje 1:** vijim
- Zonja Edén mund të bazohet në nenin 20 (1) (b) të Rregullores UEP dhe të pretendojë se ajo ishte penguar të kundërshtonte kërkesën për shkak të pandemisë Corona dhe të argumentojë se ajo përbën forcë madhore ose rrethana të jashtëzakonshme pa ndonjë faj nga ana e saj.
- Sipas Udhëzuesit Praktik të Komisionit faqe 24, shembuj të rrethanave të tilla janë: “nëse i padituri ishte në spital, me pushime, jashtë biznesit, etj.” Në varësi të ndikimit specifik, pandemia e Coronës dhe masat shtetërore si përgjigje, mund të cilësohen si një rrethanë e jashtëzakonshme. Të paktën zonja Edén mund të përpiqet të paraqesë një argument të tillë.
- Një kusht i mëtejshëm për zbatimin e nenit 20 (1) (b) të Rregullores së UEP është që Znj. Edén të veprojë menjëherë, d.m.th. që ajo të kërkojë një rishikim të UEP, përpara gjykatës kompetente në Poloni (Shteti Anëtar i origjinës), sa më shpejt të jetë e mundur.



Rasti Studimor 15: Portat e Mbyllura të Kopshtit të Edenit

Përgatitur nga anëtarët e ekipit së projektit, Uppsala: Eric Bylander dhe Marie Linton

- **Përgjigje 2:** Nëse gjykata polake vendos që rishikimi të justifikohet për një nga arsyet e përcaktuara nga neni 20 (1) ose neni 20 (2), urdhri evropian për pagesë do të jetë i pavlefshëm në përputhje me nenin 20 (3) paragrafi i dytë i Rregullores së UEP. Rezultati është që urdhri evropian për pagesë nuk mund të ekzekutohet kundër Znj. Edén në Suedi.
- Nëse, nga ana tjetër, gjykata polake refuzon kërkesën e znj. Edén bazuar në faktin se asnjë nga arsyet e rishikimit të parashikuara në nenet 20 (1) ose 20 (2) të Rregullores UEP nuk mund të zbatohen, urdhri evropian për pagesë do të mbetet në fuqi. Rezultati është që urdhri evropian për pagesë mund të ekzekutohet kundrejt Znj. Edén në Suedi.



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



FALEMINDERIT!